



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në
“Topografi dhe GIS”**

Institucioni i Arsimit të Lartë

Universiteti "Metropolitan Tirana"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Gafur Muka

2. Dr. Gjergj Thomai

Dhjetor 2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Për Programin e studimit me karakter profesional në "Topografi dhe Gis", ofruar nga
Universiteti "Metropolitan Tirana",

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Metropolitan Tirana",
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në "Topografi dhe Gis"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 461, datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 PAE / 10 PAK
18	Numri i studentëve:	2018 - 2019 6 studentë 2019 - 2020 11 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Universiteti Metropolitan Tirana përbëhet nga 3 fakultete (njësi kryesore), 8 departamente dhe 1 qendër kërkimore (njësi bazë) si më poshtë:

- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT;
- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;
- Fakulteti i Ekonomisë.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
- Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
- Qendra Kërkimore Shkencore.

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Departamenti i Shkencave të Natyrës.

Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Administrative;
- Departamenti Financë Bankë;
- Departamenti i Informatikës Ekonomike.

Struktura institucionale (akademike) organizohet në njësi mësimdhënie dhe kërkimi, që mbështeten nga organet administrative. Në Statut përcaktohen qartë edhe rolet e organeve kolegjiale dhe autoriteteve drejtuese të institucionit: Bordit të Administrimit, Senatit Akademik, Komisioneve të Përhershme, Këshillit të Etikës, Këshillit të Sigurimit të Cilësisë, Rektorit, Administratorit, dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve.

Statuti i UMT (dokumenti bazë i institucionit) përcakton marrëdhënien ndërmjet shoqërisë themeluese dhe strukturave institucionale, duke përfshirë autonominë e secilit subjekt dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.

Programi me karakter profesional 2 vjeçar “Topografi dhe GIS” i ofruar nga Universiteti Metropolitan Tirana, është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019, sipas Urdhrit nr.461, datë 27.7.2018 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë (evidenca 15)

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (FIA) i cili është një nga tre fakultetet e këtij universiteti, është njësi kryesore e cila ofron programin e studimit me karakter profesional 2 vjeçar, “Topografi dhe GIS”.

Programi me karakter profesional 2 vjeçar, “Topografi dhe GIS” ofrohet në nivel njësie kryesore (FIA) dhe njësi bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit në bashkëpunim me njësitë të tjera akademike si dhe të strukturave ndihmës akademike administrative të cilat japin kontributin respektiv në realizimin e procesit

akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit.

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës në UMT ofron 2 programe profesionale, 1 program të ciklit të parë bachelor, 2 programe të ciklit të dytë Master shkencor dhe 1 program i integruar i ciklit të dytë (5 vite akademike) me pesë profile.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimeve me karakter profesional “Topografi dhe GIS” filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. Raport i vlerësimit të jashtëm përmbledh informacione të marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces vlerësimi. Vlerësimet për çdo standart dhe fushë synojnë të paraqesë figurën sa më reale, në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. As Gafurr Muka dhe Dr. Gjergj Thomai. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Xhiliola Bixheku, Koordinatore Teknike e ASCAL.

Grupi u njoh dhe shqyrtoi dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, saktësimin e vlerësimeve, plotësimin e informacioneve dhe konkretizimin e paraqitjeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me agjendën e vizitës në institucion. Vizita u realizua me datat 07 dhe 08 tetor 2020.

Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Shefin e Departamentit të PS me karakter profesional në “Topografi dhe GIS”, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, njësinë bazë të sigurimit të cilësisë dhe zyrën e kurrikulës e cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe shërbimit të studentëve, sekretarisë mësimore, Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Hartimit e Menaxhimit të Projekteve etj. Gjithashtu GVJ vizitoi dhe mjediset mësimore, social kulturore e laboratorike ku zhvillohet programi i studimeve me karakter profesional “Topografi dhe GIS”.

Në këto takime GVJ u njoh më nga afër me nivelin e plotësimit të standarteve të kërkuara në ofertën e programit, organizimin, drejtimin dhe administrimin e tij, mësimdhënjen, mësimnxënjen dhe ushtrimin e kompetencave, burimet financiare, infrastrukturën, logjistikën për realizimin e PS me karakter profesional “Topografi dhe GIS”, trajtimin e studentëve dhe gjithë mbështetjen për ta si dhe punën që bëhej për sigurimin e cilësisë.

Më 18.11.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 18/24 Prot., datë 18.11.2020 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Nëpërmjete sistemit AMS dhe me shkresë zyrtarë Nr. 142/1 Prot., datë 02.12.2020, institucioni kthen përgjigje se nuk ka komente për këtë Draft –RVJ. Draft –RVJ kthehet në Raport Final.

Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Topografi dhe GIS”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit profesional “Topografi dhe GIS” është licensuar me Urdher Nr.461, datë 27.7.2018 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, dhe për herë të parë është aktivizuar nga UMT në vitin akademik 2018-2019. Programi i studimit profesional “Topografi dhe GIS” është hartuar në linjë me qëllimet dhe misionin e Universitetit Metropolitan Tirana. Referuar statutit dhe strategjisë së zhvillimit, misioni i UMT orientohet drejt krijimit, zhvillimit, e transmetimit të dijeve, në pajisjen me aftësi dhe kompetenca të studenteve, të nevojshme këto, për të qënë profesionistë/teknikë në Topografi dhe GIS-it <i>Evidenca 1 Statuti i UMT</i> <i>Evidenca 3 Strategjia e Zhvillimit te UMT</i> <i>Evidenca 15 Urdhri i MASR per hapjen e programit</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Referuar strategjisë së UMT, në dokumentacionin e Dosjes së Vetevlresësimit (për me tej DVV), por edhe nga takimi me drejtuesit e njësisë baze dhe ne nivel fakulteti, konstatojmë së është e mirëpërcaktuar oferta dhe drejtimit akademike, të orientuara drejt shkencave aplikative inxhinierike (teknologji informacioni, shkencat teknike), në shkencat ndërtimi (inxhinieri ndërtimi, arkitekture, urbanistike), shkencat ekonomike dhe menaxheriale (finance, administrim, informatike ekonomike).
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Universiteti ka të shprehur qartë në të gjithë dokumentet strategjike qëllimet dhe objektivat specifike, të cilët mbështesin programet e studimit si në kuadër të interesave kombëtare, sikurse edhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Konkretisht, referuar dokumentacionit për programin profesional Topografi dhe GIS, konstatojmë se në tërësinë e tij përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me aktet rregullatore të institucionit, prioritetet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitektures dhe për më tepër ato janë në të njëjtën linjë në zbatim të strategjisë së UMT dhe të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës në veçanti. Me këtë program UMT, merr detyrimin dhe përgjegjësinë e

	<p>formimit të specialisteve të topografisë dhe GIS-it në përputhje me nevojat e tregut dhe kërkesave të ekonomisë kombëtare dhe rajonale. Njëkohësisht Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitektures synon të jetë promotor i zbatimeve të modeleve të reja në këtë fushë, të hulumtojë dhe zhvillojë më tej nivelin e kërkimit shkencor dhe aplikativ në vend.</p> <p><i>Evidenca 3 Plani i zhvillimit strategjik te UMT</i> <i>Evidenca 50-56 Programi i Studimit</i> <i>Vizita ne institucion, takimi me titullarët e institucionit</i></p>
<p>Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, rezulton se UMT ka kryer studimin e tregut të punës në kuadër të hapjes së këtij programi studimi, dhe është njësia kryesore (FIA) që ndjek me kujdes dhe ka nën vëzhgim dhe analizim të vazhdueshëm tregun e punës duke e ndjekur sektorin e ndërtimit, të urbanistikës, shërbimin hartografik, kadastral etj në rajone të ndryshme të vendit si dhe bashkëpunimeve me institucione të sektorit publik dhe privat</p>
<p>Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga analiza e bërë në nivel fakulteti për tregun e punës për këtë program studimi, janë evidentuar qartë faktorët që krijojnë premisat për punësimin real të studentëve (referencë RVB, fusha 1, standardi 1.1)</p>
<p>Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimin të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Sektori i ndërtimit zë peshë të madhe të të punësuarve në vend dhe realizon një volum të madh të prodhimit kombëtar, si rrjedhojë edhe kërkesat për topograf si profesion që i shërben ndërtimit janë të mëdha. Projektet e medha të rrugëve, porteve, aeroporteve etj por edhe ndërtimet masive kërkojnë edhe kontributin e topografëve. - Formulimi dhe rinovimi i rregjistrit të tokës si dhe gjithë veprimet kadastrale përbejnë një front të gjerë pune për specialist topograf. - Studimet urbane, urbanizimi i zonave të medha rurale, por edhe i qyteteve të vegjël, si dhe nderhyrjet në qytetet e medha kërkojnë punën e topografit. - Rrjete hidraulike dhe hidroteknike, rrjetet e tjera energjetike, telekomunikacionit, studimet në fusha të ndryshme etj bazohen në të dhënat dhe punën e topografit. Etj - Zhvillimi dhe përdorimi i informacionit të marrë nga rrjetet satelitorë në shumicën e fushave të ekonomisë paraqet një perspektivë të madhe, si rrjedhim dhe specialistët e GPS-it janë shumë të kërkuar. Të gjithë fushat që kanë lidhje me zhvillime në terren punojnë, elaborojnë të dhëna, krijojnë projekte mbi harta të dixhitalizuara.

	<i>Evidenca 71 Studim tregu per programin Reference RVB Minutat e takimeve në institucion</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ konstaton se detyrat dhe përgjegjësitë në nivelin e njësive akademike apo administrative, si dhe personelit akademik dhe joakademik në UMT, janë të mirëpërcaktuara në katet themelore të institucionit: Statuti dhe Rregullore e UMT, si dhe në rregulloret specifike të njësive përbërëse të UMT (akademike dhe administrative), dhe në job description për cdo punonjës në UMT
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Bazuar në dokumentet e sipërcituar nga takimi me stafin akademik dhe atë administrativ, GVJ konstatoi se në UMT realizohet periodikisht analiza lidhur me veprimtarinë akademike dhe veprimtarinë financiare të institucionit. Njësitë kryesore hartojnë planin e aktiviteteve dhe në fund të vitit bëhet bilanci dhe analiza e realizimit/mosrealizimit të veprimtarive të planifikuara, në bashkëpunim me aktorët kryesore: departamentet dhe stafin akademik. Ka një Raport final në nivel fakulteti që është rezultat i analizave në nivel departamenti, me synimin që të evidentohen arritjet dhe problematikat, të veprimtarisë akademike dhe të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, si dhe me qëllim përmirësimit e vazhdueshëm të ecurisë të tij.
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nga evidenca përkatëse lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit, nga takimet me stafin dhe studentët, nga plani i zhvillimit strategjik të institucionit, rezultojnë se UMT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshem institucioneve të arsimit të lartë (ndërkombëtare dhe vendas) si dhe me biznese/kompani, duke mundësuar studentëve të këtij programi kryerjen e praktikave profesionale apo dhe mundësi shkëmbimi në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, si dhe në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike të institucionit në kuadër të modernizimit dhe
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të	

studentëve.	<p>ndërkombëtarizimit të tij.</p> <p>GVJ konstaton se është në prioritetet e objektivave strategjike të UMT, bashkëpunimi me institucione të ndryshme, ku përveç sa cituam më lart për zhvillimin e praktikave profesionale, iu është mundësuar studentëve dhe stafit akademik të këtij programi, mobilitet në universitete prestigjioze ndërkombëtare që vlen të përmendët si praktikë e mirë e UMT.</p> <p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimeve gjatë vizitës në vend, GVJ evidentoi faktin se në UMT, edukimi dhe inkurajimi i studenteve për të ndërmarrë iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve realizohet nëpërmjet METROincubator, i cili shërben si një laborator për të provuar dhe realizuar projekte që studentet ideojnë. Kjo realizohej me mbështetjen e specialisteve të fushave përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale</i></p> <p><i>Evidenca 23 Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FIA.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 26 Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për studentët në kuadër të erasmus+.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 27 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit, mobilitetit</i></p> <p><i>Evidenca 28 Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT</i></p> <p><i>Evidenca 32 Kriteret e pranimit në programet e ciklit të I dhe të integruar të ciklit të dytë miratuar me VSA,</i></p> <p><i>Evidenca 33 Raporti MASR mbi çertifikimin e kuotave të pranimit në UMT, viti akademik 2019-2020.</i></p> <p><i>Evidenca 36 Plan Pune 2019</i></p> <p><i>Evidenca 70 UMT Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar.</i></p> <p><i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe	Programi i studimit me karakter profesional 2 vjeçar, “Topografi dhe GIS” është organizuar në lëndë të shprehura në kredite (ECTS) dhe orë, me një total prej 60 kreditesh në një vit akademik dhe me kohëzgjatje 2 vjeçare (total 120 ECTS). Plani mësimor i vënë në dispozicion shpreh qartë mënyrën e

<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>organizimit në vite dhe semestra, me lëndët përkatëse, kreditet/lëndë, ngarkesën mësimore (sipas formave të mësimdhënies) në auditor dhe jashtë auditorit etj.</p> <p>Në DVV është paraqitur dhe grupimi i lëndëve sipas kategorive, shprehur në kredite dhe % si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë të formimit të përgjithshëm (A) – 18 ECTS (15 %), - Lëndë karakterizuese profesionale (B) – 57 ECTS (47.5%), - Lëndëve bashkëvepruese /integruese të fushës (C) – 18 ECTS (15 %), - Lëndë të aftësisimit informatik dhe praktikës profesionale (D) – 21 ECTS (17.5 %) - Punimi i temës së diplomës (E) – 6 ECTS (5 %). <p>Programi studimit me karakter profesional 2 vjeçar, “Topografi dhe GIS” është në përputhje me nivelin 5 të Kornizës Kombëtare Shqiptare.</p> <p><i>Evidenca 51 Plani mësimor Topografi dhe GIS</i></p> <p><i>Evidenca 52 Plani mësimor sipas veprimtarive.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Dosjes se Vetëvlerësimit, GVJ konstaton se programi i studimit me karakter profesional në Topografi dhe GIS synon përfundimin e njohurive të specializuara teorike dhe kryesisht praktike në Topografi dhe GIS.</p> <p>Ky program i formon studentët në dy drejtime kryesore: 1. topograf dhe 2. specialist i GIS-it, nëpërmjet Lëndëve Bazë, Lëndëve karakterizuese, Lëndëve Ndërdisciplinore/integruese, Lëndëve Plotësuesë, Praktikës profesionale dhe provës Finale që ofron programi për 2 specialitetet, por edhe fushave të afërta me to.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Specialisti topograf merr njohuri të mjaftueshme edhe për ushtrimin e profesionit në hartografi, kadastër, ndërtim, infrastrukturë transporti etj. Por edhe në drejtimin e GIS-it merr njohuri dhe aftësi në operimin dhe me modelet e GIS-it, GPS, përpunim imazhi, hartografi dixhitale etj. Harmonizimi i këtyre disiplinave në kurrikul, iu ofron dhe mundëson studentëve të kenë kompetenca dhe aftësi për një gamë të gjerë pozicione teknike të punës si topograf apo përdorues i modeleve të GIS-it.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Në rolin e ushtruesit të profesionit Topografi GIS, studentët aftësohen në kryerjen e nivelimit gjeometrik, prerjet gjeodezike, poligonet, rrjetet gjeodezike, piketimi i objekteve inxhinierike, piketimi i rrugës, rilevim me instrument Stacion Total, piketim i elementeve të rrugës me instrumentin Stacion Total, matja e sipërfaqeve me instrument Stacion Total, të punojnë me hartat etj (referencë RVB)</p> <p>Në përfundim të programit 2 vjeçar Topografi GIS, studentët</p>

	<p>pajisen me aftësi dhe kompetenca profesionale dhe teknike të ndryshme për zgjidhur kërkesat që i shtron mjedisi ku do të jetë i punësuar, si dhe për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive teknike e profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme. Programi i studimit synon të aftësojë specialiste me tipare fleksibel, të kenë diversitet (shkathtësi të transferueshme që mund ta përdorin për çdo pozicion që aplikon), përshtatshmëri, shkathtësi teknike, aftësi komunikuese por edhe aftësi organizative, menaxheriale, mbikqyrese, kjo nëpërmjet disiplinave si Menaxhimi i Punimeve në Kantier, Zbatim topogjeodezik ne ndertimin e rrugeve etj.</p> <p><i>Evidenca 50: Dosja e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidence 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i> <i>Evidence 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë se lëndëve</i> <i>Evidence 53: Plan programet e lëndëve</i> <i>Evidencë 64 Rregullore e praktikës</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Universiteti Metropolitan Tirana, është institucion i akredituar më Vendim Nr. 117, datë 15.12.2017 të Bordit të Akreditimit. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës i UMT, është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Topografi dhe GIS, përbëhet nga 3 departamente të cilët përmbushin kriteret ligjore për njësitë bazë. Programi i studimit “Topografi dhe GIS” ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit i Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës të UMT-se.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka të punësuar 7 pedagogë më kohë të plotë nga të cilët 1 Prof As, 3 DR, 2 në proces doktorature, dhe 1 Msc dhe 1 personel ndihmës-akademik, duke plotësuar në mënyrë optimale kërkesat, kriteret ligjore dhe standardet për të ofruar programin e studimit</p> <p>Gjithashtu, pjesë e Departamentit janë edhe stafi akademik me kohë të pjesshme dhe stafi i ftuar. Pjesë e stafit të ftuar theksojmë se janë personalitete të fushës se Inxhinierisë së Ndërtimit kryesisht me titull akademik, të cilët sjellin eksperiencën dhe informacionin që kanë në fushat e tyre specifike. Në stafin e ftuar bëjnë pjesë edhe pedagogë të Universiteteve të huaja si Turqi, Norvegji etj</p> <p><i>Evidenca 13: Vendim I BA për akreditimin institucional të UMT</i> <i>Evidenca 47: Organigrama e UMT</i> <i>Evidenca 58 :CV e personelit akademik</i> <i>Evidenca 63 Lista e personelit akademik me kohe te plote dhe kohe te pjesshme</i> <i>Evidenca 69 Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë</p>	<p>Programi i studimit “Topografi dhe GIS” ka të përcaktuar qartë</p>

<p>objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>objektivat që lidhen me formimin profesional të studentëve, njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale që përfitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe cdo aspekt tjetër që karakterizojnë profilin profesional të programit.</p> <p>Qëllimi i programit është që të pajisin studentët me aftësitë teorike dhe praktike më të fundit dhe njëkohësisht të pajisë studentët me aftësinë për të përdorur teknologjitë më të fundit në mënyrë eficiente në fushën e Topografi dhe GIS.</p> <p>Objektivat programit përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aftësim në përdorimin e instrumenteve moderne të precizionit të lartë për matjen dhe regjistrimin e distancave, këndeve etj. • Aftësim për realizimin e rrjeteve gjeodezike dhe e rrjetave speciale; për realizimin e rievimit topografik dhe formulimin shifror të tij; • Aftësim për realizimin e proceseve gjeodezike në ndertimin e objekteve dhe shfrytëzimin e tyre; për realizimin e punimeve gjeodezike dhe topografike në kadastrat etj; si dhe në ndërtimin e rrugëve, hekurudhave etj. • Përfitim i njohurive të punimeve ne rrjete te industrive etj; në mirembajtjen e objekteve të një rëndësie të vecantë etj. • Njohuri për shërbimet e kërkuara në fushën e matjeve profesionale inxhinierike gjeomatike; • Njohuri dhe aftësi për përdorimin e paisjeve digitale • Aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive dhe për të organizuar punë në grup.etj <p><i>Evidenca 50: Dosja e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidence 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i> <i>Evidence 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë se lëndëve</i> <i>Evidence 53: Plan programet e lëndëve</i> <i>Evidenca 54 FIA Ngarkesa ne auditore sipas formes se mesimdhenies</i> <i>Evidenca 55 FIA Rregullore e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidencë 64 Rregullore e praktikës</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Referuar DVV dhe takimeve me stafin dhe studentët, GVJ konstaton se Programi i studimit Topografi dhe GIS, përmban dhe jep informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën, kriteret e pranimit, procedurat e transferimit dhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Në programin e studimit jepet informacion specifik e i detajuar për objektivat formues të programit, si dhe objektivat formues për cdo lëndë, grupimin e disiplinave sipas veprimtarive formuese, format e mësimdhënies, detyrimet për lëndën, mënyrat e vlerësimit të njohurive të lëndës, rezultatete e të nxënit etj;</p> <p><i>Evidenca 50: Dosja e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidence 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i> <i>Evidence 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë se lëndëve</i> <i>Evidence 53: Plan programet e lëndëve</i> <i>Evidenca 54 Ngarkesa ne auditore sipas formes se mesimdhënies</i> <i>Evidenca 55 Rregullore e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidencë 64 Rregullore e praktikës</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit profesional 2-vjeçar “Topografi dhe GIS” është organizuar në lëndë të shprehura në kredite (ECTS) dhe orë, me një total prej 60 kreditesh në vit akademik (total 120 ECTS) dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike/4 semestra, me kohë të plotë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këto lloj programesh.</p> <p>Nga takimi me titullarët e fakultetit/departamentit dhe RVB, u konstatua se në hartimin e programit është shfrytëzuar përafrimi</p>

i programeve të studimit me ato të ofruara në universitete perëndimore (Itali, Greqi), duke sjellë një përjasje dhe përshtatje të kurrikulës së këtij programi me ato të vendeve të tjera, e për pasojë mundësi të larta transferimi studimesh apo punësimit të të diplomuarve dhe në nivel ndërkombëtar

Struktura e programit të studimit Program profesional 2-vjeçar “Topografi dhe GIS”, bazuar në objektivat e programit, përgatit studentët me aftësi dhe kompetenca praktike profesionale për të qenë konkurrues në tregun e punës. Këto aftësi merren nëpërmjet formave të mësimdhënies me orientim praktik (detyra kursi, laboratore, workshope) apo praktikës mësimore dhe asaj profesionale që janë pjesë përbërëse e programit të studimit, ku shpërndarja e ngarkesës së formimit teorik dhe atij praktik është në përputhje me legjislacionin e fuqi për këto lloj programesh.

Programi i studimit ofron një gamë të gjerë njohurish në kategorinë e lëndëve të formimit të përgjithshëm A (15%), në kategorinë e lëndëve karakterizuese profesionale B (47.5 %), në kategorinë e lëndëve integruese të fushës C (15 %), dhe në kategorinë e lëndëve të aftësimit informatik dhe praktikës profesionale D (17.5 %) dhe provim final E (5 %).

Referuar DVV, për organizimin e programit të studimit, disponohet dokumentacion i plotë për programin e studimit ku përfshihen:

- Të dhëna të përgjithshme për njësinë dhe programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse, regjistrimet, transferimet, tarifatat, metodat e mësimdhënies etj.
- rregullorja e programit,
- plani mësimor;
- syllabuset e lëndëve si dhe ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese shqip dhe anglisht, CV e personelit akademik.

Evidenca 50: Dosja e programit të studimit Topografi dhe GIS

Evidenca 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës

Evidenca 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë së lëndëve

Evidenca 53: Plan programet e lëndëve

Evidenca 54 Ngarkesa në auditore sipas formës së mesimdhënies

Evidenca 55 Rregullore e programit të studimit Topografi dhe GIS

Evidenca 60 Rregullore e provimeve

Evidenca 61 Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të

	<p><i>diplomës Topografi dhe GIS</i></p> <p><i>Evidenca 62 Plan pune për punimin e diplomës_Topografi dhe GIS</i></p> <p><i>Evidencë 64 Rregullore e praktikës</i></p> <p><i>Evidenca 3:Zhvillimi startegjik i UMT</i></p> <p><i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Referuar dokumentacionit për programin Topografi GIS, sipas evidencave 50-58, konstatojmë se plani mësimor, një ndër dokumentet kryesore të programit, shpreh qartë organizimin sipas viteve akademike të lëndëve të planifikuara. Cdo vit akademik është i ndarë në 2 semestra. Në plan mësimor ka informacion të plotë lidhur me lëndët për cdo semestër, ngarkesën mësimore në auditor sipas formave të mësimdhënies, ngarkesën në kredite për secilën veprimtari/disiplinë etj. në përputhje me VKM nr.41/2018. Plani mësimor ndjek llogjikën e realizimit të lëndëve, shpërndan kreditet (orët) sipas lëndëve dhe brenda cdo lëndë sipas formës së transmetimit (leksione, seminare, ushtrime, detyra, laboratore, praktika).</p> <p>Një përqindje të konsiderueshme të programit të studimit zë praktika në terren me 12 kredite, e cila realizohet në përputhje me rregulloren specifike dhe në bashkëpunim me kompani gjeodezike. Nga takimi me studentët rezultoi se studenti është i detyruar të mbajë dhe të plotësojë relacionin e praktikës, gjatë zhvillimit të praktikës studenti monitorohet nga pedagogët përgjegjës të përcaktuar nga departamenti.</p> <p>Metodat e mësimdhënies në këtë program studimi janë konceptuar dhe strukturuar në mënyrë të ekuilibruar midis të gjitha metodave didaktike të mësimdhënies si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione interaktive 440 orë - Seminare/Ushtime 360 orë - Projekte/Detyrë kursi 75 orë - Laboratorë 145 orë - Praktikë në terren 240 orë - Diploma 24 orë <p><i>Evidenca 50: Dosja e programit të studimit Topografi dhe GIS</i></p> <p><i>Evidenca 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i></p> <p><i>Evidenca 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë së lëndëve</i></p> <p><i>Evidenca 53: Plan programet e lëndëve</i></p> <p><i>Evidenca 54 Ngarkesa në auditore sipas formës së mesimdhënies</i></p> <p><i>Evidenca 55 Rregullore e programit të studimit Topografi dhe</i></p>

	<p><i>GIS</i></p> <p><i>Evidenca 60 Rregullore e provimeve</i></p> <p><i>Evidenca 61 Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës Topografi dhe GIS</i></p> <p><i>Evidenca 62 Plan pune për punimin e diplomës_Topografi dhe GIS</i></p> <p><i>Evidencë 64 Rregullore e praktikës</i></p> <p><i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Topografi dhe GIS përmban syllabuset për secilën lëndë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi (sipas VKM 41/2018 i ndryshuar) .</p> <p>Në syllabuset e paraqitura, pasqyrohen elemente si: lektori/lektorët që do të zhvillojnë lëndën, emërtimi i lëndës, semestri kur zhvillohet, karakteri i modulit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, kohëzgjatja e modulit, kreditet, objektivat e modulit, elementët e mësimdhënies, detyrimet e studentit, metodat dhe mënyra e kontrollit të dijeve, literatura etj. Studentëve ju vihet në dispozicion plan programi i lëndës (syllabusi) gjatë javës së parë të fillimit të lëndës.</p> <p><i>Evidence 53: Plan programet e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Struktura dhe organizimi i kurrikulës së programit topografi dhe GIS është hartuar me synimin e harmonizimit të ngarkesës mësimore të formimit teorik me ngarkesën e orëve të formimit praktik, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione interaktive 440 orë - Seminare/Ushtime 360 orë - Projekte/Detyrë kursi 75 orë - Laboratorë 145 orë - Praktikë ne terren 240 orë
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Kjo shpërndarje e ngarkesës mësimore, u mundëson studentëve formimin e tyre përgjatë programit dhe në përshtatje dhe me punësimin e tyre.</p> <p>Sic është referuar dhe në DVV dhe RVB, programi synon të përgatisë studentët për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - aktivitete prodhuese, teknike dhe projektuese; - të punojë me hartat e plane topografike (leximi, krijimi, përdorimi), si dhe me materialet e GIS-it; - të punojë me pajisje moderne gjeodezike; - përpunimin e rezultateve të të dhënave të informacionit gjeodezik (përpunimi i zyrës); - zbërthimin e projekteve gjeodezike; - sjellja e pavarur ne punët gjeodezike, si në terren, ashtu edhe në fazën e zyrës; - vetëtrainim dhe vetë-përvetesim;

	<p>- aftësia për të mbajtur përgjegjësi për marrjen e vendimeve; - kërkimin dhe analizën e informacionit të specializuar shkencor dhe teknik të nevojshëm për kryerjen e hulumtimit, studimit, punës gjeodezike. etj</p> <p>Në këtë kontekst, GVJ konstaton se formimit praktik të studentëve ka një peshë specifike më të madhe në teresine e formimit të studentit, në përputhje me profilin profesional të programit. Referuar planit mësimor të programit “Topografi dhe GIS” rezulton se raporti i orëve teori me praktikë del afërsisht 1:2, (440/840) raport ky brenda kërkesave të Kornizës Europiane të Kualifikimeve dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Një nga pengesat e hasura nga institucioni (referuar RVB dhe takimeve gjatë vizitës në UMT) është se tregu i punës në vend nuk është ndërgjegjësuar plotësisht që specialistet e kualifikuar mund të përgatiten dhe t’i ofrohen edhe nga shkolla dhe programet profesionale studimi.</p> <p><i>Evidenca 50: Dosja e programit të studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidenca 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i> <i>Evidenca 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë së lëndëve</i> <i>Evidenca 53: Plan programet e lëndëve</i> <i>Evidenca 54 Ngarkesa në auditore sipas formës së mesimdhënis</i> <i>Evidenca 55 Rregullore e programit të studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidencë 64 Rregullore e praktikës</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënësve sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në DVV, GVJ konstaton se emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite, ngarkesa mësimore është në

nënligjore në fuqi.	përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi
<p>Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimit e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit profesional në “Topografi dhe GIS”, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike/4 semestra. Një krediti i korrespondon 25 orë mësimore punë të studentit, përbërë nga orë mësimore në auditor (leksione, seminare, praktika, detyra etj.) dhe orë për punë individuale të studentit. Raporti teori/praktikë është në favor të orëve praktike duke plotësuar këtë program me kërkesat e Nivelit 5 të KShK.</p> <p>Programi mësimor “Topografi dhe GIS” u mundëson studenteve njohuri, shprehi dhe aftësi dhe kompetenca praktike gjë që ndihmon në lehtësimin e punësimit dhe arritjen e suksesit në ushtrimin e profesionit.</p> <p><i>Evidenca 50: Dosja e programit të studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidenca 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i> <i>Evidenca 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë së lëndëve</i> <i>Evidenca 53: Plan programet e lëndëve</i> <i>Evidenca 54 Ngarkesa në auditore sipas formës së mesimdhenies</i> <i>Evidenca 55 Rregullore e programit të studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së programit të studimit në Topografi GIS, rezultojnë që jepet i detajuar plani mësimor me elementet përbërës (lëndët, ngarkesa në auditor për çdo lëndë/veprimtari sipas formave të mesimdhenies, kreditet përkatëse të lëndës, kategorizimi i lëndës (nga A-E); syllabuset e lëndëve të programit të studimit “Topografi dhe GIS” kanë të gjithë elementet e përcaktuar sipas VKM 41/2018, të cilat ofrojnë informacion të plotë për studentin dhe për stafin akademik.</p> <p>Syllabus-et e çdo lëndë, kanë të pasqyruar elementët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Emërtimi i lëndës/modulit</i> • <i>Emri i titullarit / pedagogut që do të zhvillojë lëndën</i> • <i>Ngarkesa: (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.)</i> • <i>Tipologjia e lëndës</i> • <i>Viti akademik/semestri kur zhvillohet lënda</i> • <i>Lloji i lëndës: (e detyrueshme ose me zgjedhje)</i> • <i>Programi i studimit: (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë)</i> • <i>Kodi i lëndës</i> • <i>Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës</i> • <i>Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit:</i> • <i>Përfitimet nga lënda</i>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Konceptet themelore</i> • <i>Temat e lëndës</i>

<p>teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>•<i>Format e kontrollit të dijeve/ Frekuentimi / Kontrolli i vazhdueshëm:</i></p> <p>•<i>Literatura e ndarë në a) literatura bazë e detyrueshme, b) literatura e rekomanduar)</i></p> <p>•<i>Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës</i></p> <p>Sic është afirmuar dhe në RVB, UMT-ja ka në proritë plotësimin e literaturës se dedikuar për këtë program studimi profesional.</p> <p>Raporti midis lëndëve të formimit teorik dhe praktik është i balancuar (440:580) dhe në përputhje me profilin profesional të programit të studimit. Praktika mësimore në terren që është shumë e rëndësishme për aftësimin në praktikë/punë të studentit në profesion, zë një ngarkesë prej 240 orësh (rreth 24 %).</p> <p><i>Evidenca 50: Dosja e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidence 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i> <i>Evidence 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë se lëndëve</i> <i>Evidence 53: Plan programet e lëndëve</i> <i>Evidenca 54 Ngarkesa ne auditore sipas formes se mesimdhënies</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Përbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Programi profesional i studimit “Topografi dhe GIS”, referuar DVV dhe vizitës ne vend, rezulton se ka objektiva të mirë përcaktuara për formimin e studenteve me njohuri teorike dhe praktike, aftësi dhe kompetenca profesionale ne topografi dhe GIS, në përputhje me profilin e programit dhe në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen, duke ju mundësuar studenteve formimin e tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 2. Përbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Programet e lëndëve janë hartuar me qëllimin që studenti të fitojë njohuritë bazë dhe me gamë të gjerë në fushën e topografisë dhe GIS-it. Në syllabuset e lëndëve në mënyrë të hollësishme jepen kohëzgjatja e trajtimit të tyre, literatura</p>

	<p>përkatese dhe objektivat që duhen arritur. Në program janë parashikuar lëndë të cilat trajtojnë teknika dhe teknologji të zhvillimeve të fundit në një nivel arsimi profesional, duke mundësuar plotësimin e pritshmërive dhe kërkesave të punëdhënësit për këtë profesion.</p> <p><i>Evidence 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i></p> <p><i>Evidence 53: Plan programet e lëndëve</i></p> <p><i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Referuar Dosjes se programit Topografi dhe GIS, përkatësisht përmbajtjes së tij, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të programit të studimit, studentët zhvillojnë aftësi profesionale nëpërmjet ndërthurjes së elementeve të studimit teorik me mjeshtëritë teknike, si dhe pajisen me njohuri dhe aftësi të transferueshme.. Aftësitë e transferueshme (referuar RVB) shprehen ne:</p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ krijimtari - të mësuarit me frymëzim nga teknika të reja dhe përdorimin e tyre; ○ puna në ekip – duke marrë pjesë e bashkëpunuar në disa projekte krijuese në grupe; ○ menaxhimi i kohës se nevojshme për realizimin e nje projekti; ○ aftësitë analitike te te menduarit, të gjykuarit, te schedulimit te programimit te punimeve; ○ aftësitë teknike – duke mësuar një shumëllojshmëri të paketave kompjuterike dhe aftësi të nevojshme për zbatim praktik ○ aftësi dhe shkathtësi hulumtuese; ○ kapacitet për të punuar në mënyrë të pavarur - në mënyrë që të realizojnë punën e tyre dhe për të ndërtuar portofolin e tyre; ○ aftësitë sipërmarrëse - portofoli i tyre duhet të jetë krijues, imagjativ dhe komercial. <p>Programi i trajton lëndët si pjesë të vecanta të një boshti të përgjithshëm, pra janë elemente të së tërës, gjë që vendos midis tyre një lidhje harmonike. Konceptet plotësojnë njeri tjetrin dhe në tërësinë e tyre plotësojnë formimin e plotë profesional të studentit.</p> <p>Bazuar në strukturimin e programit, ndërthurjen e teorisë me praktikën, praktika në terren etj, programi mundëson përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>

	<p><i>Evidenca 50: Dosja e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidenca 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i> <i>Evidenca 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë se lëndëve</i> <i>Evidenca 53: Plan programet e lëndëve</i> <i>Evidenca 54 Ngarkesa ne auditore sipas formes se mesimdhenies</i> <i>Evidenca 55 Rregullore e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>GVJ, bazuar në strategjinë e zhvillimit të UMT, konstaton se është në objektivat startegjike të institucionit ofrimi i programeve të studimit në përputhje me objektivat e zhvillimit të vendit</p> <p>Specifikisht, në planin strategjik të zhvillimit të programit synohet që ky program tu pergjigjet sfidave të mjedisit kompleks dhe të ndryshueshëm, me qëllim që specialistët e Topografisë dhe GIS të pozicionohen shpejt dhe në mënyrë efikase në tregun e punës. UMT ofron programe studimi që integrohen me specialitetin në fjalë si inxhinieria e ndërtimit, arkitektura, urbanistika, infrastruktura e transportit, ekziston mundësia dhe përgatitja e studenteve të jetë me pranë realitetit praktik të pasdiplomimit.</p> <p>UMT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme, sipas profileve të programeve të studimit që ofron, në funksion të praktikave profesionale që kryejnë studentët Studentët gjatë kryerjes së praktikave profesionale mbikqyren nga stafi akademik i ngarkuar. Modalitetet e kryerjes së praktikës, përzgjedhjes së kompanisë ku do kryhet ajo, janë të përcaktuara qartë, në përputhje me rregulloren për praktikën profesionale duke siguruar harmonizim dhe larmishmëri në shpërndarjen e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.</i> <i>Evidenca 23 Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te FIA</i> <i>Evidenca 50: Dosja e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidenca 51: Plani mësimor Topografi dhe GIS me elementët përbërës</i> <i>Evidenca 52: Plani mësimor Topografi dhe GIS sipas veprimtarisë se lëndëve</i> <i>Evidenca 53: Plan programet e lëndëve</i> <i>Evidenca 54 Ngarkesa ne auditore sipas formes se mesimdhenies</i> <i>Evidenca 55 Rregullore e programit te studimit Topografi dhe</i></p>

	<i>GIS</i> <i>Evidencë 64 Rregullore e praktikës</i> <i>Evidenca 3: Plani I zhvillimit strategjik te UMT</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Referuar Statutit dhe Rregullores së UMT-së, GVJ konstaton se është përcaktuar qartë struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UMT, që është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), për monitorimin e cilësisë dhe zhvillimin e mekanizmave të cilësisë, bazuar në rregulloren e saj.</p> <p>Nga takimi me NJSBC dhe titullarin e departamentit, stafin akademik dhe studentet, GVJ konstatoi se NJSBC bashkëpunon ngushtë me Fakultetin, departamentin përgjegjës për programin e studimit në fjalë.</p> <p>NJSBC së bashku me përgjegjësit e departamenteve dhe grupe të ndryshme Ad-hoc organizojnë monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim nxënies në të gjithë elementët e saj si në procesin e leksioneve, seminareve, punëve laboratorike dhe praktikës profesionale, sipas planit të punës të përcaktuar.</p> <p>GVJ konstati se NJSBC zhvillonte mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Kjo realizohej nëpërmjet</p>

	<p>pyetësorëve/anketimeve vlerësuese për çdo lëndë, ku studenteve iu jepej të shpreheshin në mënyrë të lirë dhe të pavarur duke ruajtur anonimin. Rezultatet e këtyre vlerësimeve pasi grupoheshin dhe analizoheshin përbënin objekt analize në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti.</p> <p>Nëpërmjet NJSBC, UMT rezulton se ka të organizuar në mënyrë funksionale sistemin e brendshëm të cilësisë, i cili funksion si më poshtë:</p> <p>Kryen rolin e monitorimit, të gjithë aktivitetit mësimor, duke mbikëqyrur procesin e mësimin në të gjitha elementet e tij, duke mbledhur informacione dhe evidentuar probleme të ndryshme.</p> <p>Realizon mbështetje dhe ekspertizë, që synon evidentimin e problemeve që në fazën e lindjes se problemeve të procesit mësimor, me qëllim që të parandalohen zgjatja e tyre.</p> <p>Kryen rolin e bashkërenduesit, i cili realizohet nëpërmjet një procesi koordinimi të realizimit të gjitha detyrave dhe objektivave që kërkohet të realizohet jo vetëm nga një njësi (departament, apo fakultet), por edhe nga njësitë e tjera të fakultetit apo dhe universitetit.</p> <p>Bën mentorimin e procesit, i cili aplikohet duke studiuar metodat dhe metodologjitë më të përparuar të procesit të mësimdhënies dhe mësim nxënies dhe duke organizuar punën më stafin dhe organet drejtuese për ti zbatuar ato metoda, teknika me efektivitet dhe eficiencë.</p> <p>Bën interpretimin e të gjithë legjislacionit dhe dokumenteve të ndryshme udhëzuese/dokumentave, lidhur me sigurimin e cilësisë.</p> <p>Administron dokumentacionin lidhur me planifikimin, kontrollin e zbatimit dhe përmirësimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 7 VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidenca 8 Përbërja e NjSBC.pdf</i> <i>Evidenca 9 Rregullore e NjSBC.</i> <i>Evidenca 10 Analiza e NjSBC për pyetësorët e stafit akademik</i> <i>Evidenca 11 Model i pyetësorit për studentët</i> <i>Evidenca 70 Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme</p>	<p>Referuar DVV, GVJ konstaton se për programin e studimit Topografi dhe GIS, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit, praktikat profesionale e mësimore, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>

<p>për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Karakteristikë e stafit akademik të programit të studimeve në “Topografi dhe GIS” është background i tyre profesional në praktikën kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Referuar RVB, GVJ konstatoi që numri i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi është 18. Nga të cilët 8 janë personel akademik me kohë të plotë (PAE), 1 Prof. Dr., 3 Dr. dhe 4 Msc, ndërsa 10 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët 1 Prof. Dr., 3 Dr. dhe 6 Msc. Stafi akademik PAE mbulon rreth 63% të ngarkesës mësimore kurse stafi PAK mbulon rreth 36% të ngarkesës. Në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore departamenti dhe IAL bazohet tek udhëzimi 29/2018 i ndryshuar, ku asnjë nga personeli akademik nuk e kalon numrin në orë dhe në lëndë të përcaktuar në këtë udhëzim.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Vlen të theksojmë se stafi akademik i këtij programi studimi janë me background kryesisht profesional, pasi nuk ka staf akademik me tituj/grada specifiku në fushat e topografi dhe GIS, duke qenë fusha me karakter thellësisht teknik dhe profesional. Për më tepër gjykojmë se angazhimi i stafit akademik me profil profesional mundëson ofrimin me cilësi të programit profesional, duke aftësuar studentët në këtë drejtim dhe duke përmbushur objektivat e nivelit dhe programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Duke konsultuar CV e tyre konstatohet që angazhimi është në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikat e lëndëve. Konkretisht, për lëndët e formimit bazë (matematike, fizikë, bazat e informatikës etj) janë angazhuar personel akademik me kohe të plotë të universitetit që kanë eksperiencë në mësimdhënie në fushat përkatëse (referuar CV). Përsa i përket lëndëve të formimit profesional (aplikime gjeodezike, zbatimi topogjeodezik, përpunim imazhi etj) janë angazhuar personel akademik të formuar dhe profesionistë me eksperiencë në fushën specifike të lëndës.</p> <p>Zyra dhe sallat ku realizohet procesi mësimor janë të kompletuara me të gjitha mjetet e nevojshme: me kompjuter me programet përkatëse, me projektor, me tabela te cilësisë sa larte, etj.</p> <p>Departamentet organizojne pjesmarrjen reciproke të anëtarëve të stafit në orët e mësimin të njeri tjetrit.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, përgjegjës për programin e studimit në vlerësim, ka në përbërjen e tij 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët 4 me tituj grada, 2 në proces doktorate dhe 1 Msc. Referuar CV të tyre akademike, se fusha akademike përputhet me profilin e departamentit dhe të fakultetit.</p> <p>Institucioni mbështet stafin përmes njohjes me shembujt e</p>

	<p>praktikave të mira, si dhe nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Si rast konkret gjate takimeve u evidentua veprimtaria e javës së inovacionit ku profesorë të njohur ndajnë eksperiencat e tyre të sukseshme në fushat përkatëse (referencë RVB dhe nga takimi me stafin akademik).</p> <p>Janë zhvilluar një numër seminaresh në lidhje me metodat e mësimdhënies me pedagogë të Universiteteve të huaja dhe kryesisht me ato italiane, greke dhe polake, ku përfaqësues të tyre nëpërmjet programeve ERASMUS, kanë dhënë eksperiencën e tyre në UMT. Po kështu janë zhvilluar një numër ëorkshopesh mbi zhvillimin e GIS me specialist shqiptar dhe të huaj dhe mënyrën e transmetimit të informacionit mbi këtë temë.</p> <p><i>Evidenca 25 Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik në kuadër të erasmus+</i></p> <p><i>Evidenca 28 Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT</i></p> <p><i>Evidenca 66 Te dhena per mbulimine lendeve me personel akademik</i></p> <p><i>Evidenca 69 Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve</i></p> <p><i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	GVJ, mbështetur në dokumentacionin përkatës, vizitën në institucion dhe RVB, konstaton se UMT ka në dispozicion të procesit mësimor infrastrukure fizike dhe zhvillon veprimtarinë e akademike dhe administrative, përkatësisht: në godinën qendrore në Rrugën “Sotir Kolea” me sipërfaqe 2350 m ² dhe në godinën në Rrugën “Budi” me sipërfaqe 2490 m ²
	Godinat në të cilat zhvillohet procesi i mësimdhënies, janë godina të reja, të ndërtuara vitet e fundit, me standarde të larta ndërtimore si dhe që përmbushin kriteret për zhvillimin e aktiviteteve mësimore.

	<p>Ambientet ku zhvillohet kërkimi, mësimi dhe zyrat , të cilat u panë gjatë vizitës në vend, janë të pajisura në përshtatje me funksionin që ato kryejnë, të ndriçuara maksimalisht, me akustikë të përshtatshme, me sistem individual kondicionimi dhe me inverter për ngrohje dhe ftohje. Auditoret për mësimdhënie janë të pajisura me projektorë, me qasje në internet nga çdo vendndodhje në hapësirën e godinës.</p> <p>Ambientet janë të pajisur me sistem mbrojtës kundra zjarrit të lëvizshëm dhe statik, me mjetet e nevojshme të ndihmës së shpejtë për çdo kat, me furnizim të pandërprerë me ujë falë depozitave të ujit me vëllim të mjaftueshëm, me sistem alternativ në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike nga rrjeti dhe me ambiente të shërbimit për nevoja personale në çdo kat.</p> <p><i>Evidenca 91 Ambjente per infrastrukture UMT</i> <i>Evidenca 92 Asetet Infrastrukturore akademike</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion dhe vizita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>UMT përdor sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. Sistemi i Menxhimit të të dhënave mundëson menaxhimin e integruar të tyre për programet akademike dhe kurikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët. Sistemi është një platformë e integruar bazuar në një arkitekturë modulare duke krijuar mundësinë e personalizimit të tij sipas nevojave dhe specifikave të UMT-se.</p> <p>Sistemi menaxhon te dhenat e studentëve që kanë frekuentuar ose frekuentojnë një program studimi që ofron Universiteti. Sistemi i IT-së është i personalizuar për të kryer funksione te ndryshme të menaxhimit të procesit mësimor, të menaxhimit të sekretarisë dhe elementë të tjerë të menaxhimit. Pedagogët hedhin në sistem syllabuset , materialet didaktike , mungesat e studenteve dhe vlerësimet vjetore. Nga ana tjetër studentët mund të shohin ecurinë e tyre vjetore direkt ne sistem gjate te gjithë vitit.</p> <p>Përveç sistemit të informacionit në aspektin e menaxhimit, UMT-ja ka një sistem informatik bashkekohor dhe cilësor në aspektin e kërkimit dhe të zhvillimit të procesit mësimor, kjo fale dhe Fakultetit te Shkencave Kompjuterike dhe IT qe eshte njesi kryesore e UMT.</p> <p><i>Evidenca 39 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.</i> <i>Evidenca 40 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve.</i> <i>Evidenca 41 Ndërfaqja, administratori, pedagogu, sekretaria, studenti.</i> <i>Evidenca 42 Modele Procesverbale provime, listë notash studenti, vërtetime studenti.</i> <i>Evidenca 43 Print Screen të faqes web lidhur me veprimtarinë</i></p>

	<p><i>kërkimore shkencore</i> <i>Evidenca 44 Platforma për mësimin online</i> <i>Evidenca 45 Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit për syllabuset, nga takimi me stafin dhe studentët, si dhe referuara RVB, GVJ konstatoi se një pjesë e lëndëve të programit “Topografi dhe GIS”, përdorin leksione të shkruara nga pedagogët, si letaturë bazë, pasi për këtë program specifik nuk ka literaturë ekzistuese.</p> <p>Nga takimi i GVJ me stafin dhe studentët, u evidentua fakti që platforma e përdorur për procesin mësimor online “edu4school”, ka luajtur rol të rëndësishëm në shpërndarjen e materialit didaktik që pedagogët u japin studentëve (leksione, shënime teorike dhe aplikative, prezantime ligjëruese, detyra të kursit, temat dhe ushtrimet dhe praktika laboratorike). Kjo platformë kishte mundur komunikimin suplementar sinkron pedagoge-studente, si dhe "dixhitalizimin" e plotë të materialit didaktik. Departamenti parashikon që në të ardhmen materialet didaktike baze të mund të botohen në formën e librave.</p> <p><i>GVJ, në mbështetje dhe të afirmimit të vetë institucionit rekomandon që brenda dy viteve të ardhshme të shihet mundësia e plotësimit me literature të dedikuar për këtë program</i></p> <p>Tendence e gjithë UMT është që materialet dhe librat që përdoren të jenë aktuale, edicione të fundit dhe jo më shumë se disa vjet në përdorim.</p> <p><i>Evidenca 44 Platforma për mësimin online</i> <i>Evidenca 45 Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë</i> <i>Evidenca 53 Plan e lendeve Topografi GIS</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në bibliotekë, takimi me studentët GVJ konstatoi se biblioteka mundëson aksesin në libraritë on line si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët. Staf i bibliotekës ofron mbështetje gjetjen e burimeve on-line të kërkuara. Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UMT-ja. Pedagogët dhe studentet përdorin gjithashtu portale dhe biblioteka, aksesimi në të cilat është falas (referencë RVB).</p> <p><i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV konstatohet se UMT, për shkak dhe të programeve në shkencë aplikative që ofron, ka infrastrukturë laboratorike mëse të mjaftueshme që shfrytëzohen nga studentët për realizimin e orëve laboratorike, detyrave të kursit apo diplomave. Laboratori mbetet struktura</p>

mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	ku jo vetëm mësohet por edhe bëhet kërkimi shkencor dhe profesional. Laboratorët e informatikës janë të mirëpajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programet mësimore. UMT ka marrveshje me studio dhe kompani gjeodezike për shfrytëzimin e bazës së tyre të instrumentave <i>Evidenca 91 Ambjente per infrastrukture</i> <i>Evidenca 92 Fasetet Infrastrukurore akademike.</i>								
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	UMT ofron plotësisht mësimin online në situatën e krijuar nga pandemia (takimi me stafin dhe studentët) nëpërmjet platformës on-line (<i>e-learning</i>) “GoToMeeting-GTM” dhe “Edu4school”. Në funksion të këtij procesi, UMT kishte hartuar udhëzimin përkatës për mësimdhënien online. Personeli akademik i njeh studentët me materialet didaktike brenda orës së mësimin në platformën elektronike <i>edu4school</i> e cila është e aksesueshme nga studentet on-line, 24 orë në ditë. Personeli akademik dhe studentet indentifikoheshin nëpërmjet adresave personale të emailit të UMT, (emër.mbiemer@umt.edu.al) <i>Evidenca 44 Platforma për mësimin online.pdf</i> <i>Evidenca 45 Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.</i> <i>Evidenca 86 Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Programet e Studimit që ofron UMT, janë të organizuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, me të gjitha elementet përbërës. Monitorimi i zbatimit të programit të studimit (planit mësimor, syllabusese, aktiviteteve të planifikuara), bëhet periodikisht nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me synimin e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies. GVJ, sic ka cituar dhe më lart, ka evidentuar instrumentet dhe mekanizamat që përdor kjo njësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Një nisme e re që ishte ndërmarë këtë vit akademik, sic u pohua dhe në takimet me stafin dhe studentët ishte “sistemi i tutoriatit” sipas grupeve mësimore,
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe	

<p>studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>praktike e mirë e universiteteve ndërkombëtare.</p> <p>Departamenti është njësi që përcakton koordinatorët (Këshilltarët akademikë), të cilët në bashkëpunim me NJSBC, e mbikëqyrin dhe monitorojnë tërë procesin mësimor. Këto njësi bëjnë edhe përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (njësi kryesore) dhe Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit (njësi bazë) janë përgjegjëse për programin e studimit dy vjeçar “Topografi GIS”. Në funksion të mbarëvajtjes të procesit mësimor janë të angazhuar këshilltarët akademikë, përgjegjësit e departamenteve dhe deri tek dekani i Fakultetit. Këto struktura nxisin, promovojnë dhe orientojnë personelin akademik në rritjen e cilësisë së programit të studimit. Strukturat nxisin studentët që të jenë pjesë e procesit të evidentimit të problematikave me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>Ishte në frymën e institucionit, mbështetja ndaj stafit akademik për forma të reja e bashkëkohore të mësimdhënies dhe mënyrat e aplikimit të tyre me vendosjen e studentit në qendër.</p> <p>Lidhur me metodat inovative të mësimdhënies, në kushtet e pandemisë COVID-19, UMT iu kishte mundësuar q studentëve (të cilët pajiseshin me laptop në momentin e regjistrimit në programin përkatës) procesin e mësimdhënies online.</p> <p><i>Evidenca 9 Rregullore e NjsBC.pdf</i> <i>Evidenca 10 Analiza e NjsBC për pyetësorët e stafit akademik</i> <i>Evidenca 11 Model i pyetësorit për studentët.pdf</i> <i>Evidenca 96 Vendim për përcaktimin e Keshiltarve Akademik sipas viteve të studimit.</i> <i>Evidenca 44 Platforma për mësimin online</i> <i>Evidenca 45 Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.</i> <i>Evidenca 86 Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e Departamentit, stafin akademik, NJSBC, u evidentua fakti që konceptimi i procesit mësimor është bërë duke synuar vënjen e studentit në qendër. Kjo kishte sjelle ndryshim nga metoda tradicionale, duke i dhënë më shumë mundësi pjesëmarrjes në diskutime dhe pyetje studentit. Zhvillimi i orëve interaktive, të cilat ndërthurin shpjegimet në nivel teorik dhe empirik, duke u përqendruar në bashkëveprime të vazhdueshme midis profesorit dhe studentit, nxitja e debateve, mendimit kritik, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet e punimeve janë disa prej mjeteve kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në mënyrë aktive në procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe</p>	

<p>raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Eksperiencat në Universitete homologe evropiane në kuadër të programit Erasmus kanë rritur cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Metodat e reja të mësimdhënies, nëpërmjet seminareve të dedikuara, leksioneve të hapura workshope etj, janë bërë të njohur në të gjithë trupen akademike të UMT, me qëllim përmirësimin e këtij procesi në vijimësi.</p> <p>Përfshirja e studenteve dhe vjelja e mendimit të tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së personelit akademik dhe metodave të mësimdhënies ka qenë dhe është periodik për të gjitha aspektet akademike dhe administrative të UMT.</p> <p><i>Evidenca 28 Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT</i> <i>Evidenca 53 Plan e lendeve Topografi GIS</i> <i>Evidenca 86 Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.4</p> <p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë. Çdo program lënde (syllabus) përmban temat të ndërlidhura që zhvillohen gjatë një semestri. Vlerësimi i njohurive, dijeve, i shprehive dhe aftësive teknike dhe profesionale për çdo lëndë mbart jo vetëm rezultatin e kontrollit në fund të kursit të çdo disipline por edhe progresin gjithë semestral. Vlerësimi bëhet për çdo disiplinë me vete me note. Studenti ka të drejtën e ankimit ose rishikimit të kontrollit të kryer, sipas afateve dhe procedurave në fuqi të UMT-se. Sistemi i testimit dhe vlerësimit të dijeve karakterizohet nga diversiteti, transparenca dhe fleksibiliteti. Në UMT, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse (referencë RVB dhe nga takimet me stafin dhe studentët).</p>
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive,</p>	<p>Kontrolli i i dijeve të studentit për lëndën, është kontroll i vazhdueshëm gjatë zhvillimit të lëndës dhe ajo e testimit përfundimtar të lëndës. Pësha e secilës prej formave të</p>

<p>dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>vlerësimit, referuar syllabuseve të lëndëve, është specifike sipas formave të mësimdhënies që parashikon lënda. Në mënyre të pëmbledhur, jepet si me poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Frekuentimi dhe aktivizimi 10 % (secila me nga 5%) • Testime/provime të ndërmjetme deri në 20% • Detyra kursi 10% • Provimi përfundimtar 60 % <p>Bazuar në rregulloren e UMT-së dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit që e plotësojnë atë, përcaktohet qartë detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lende me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve /moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Syllabuset e çdo lëndë përmbajnë kontrollet që do të kryhen gjatë zhvillimit të saj. Vlerësimi i kontrolleve bëhet me pikë që i bashkohen vlerësimit përfundimtar. Në vlerësimin përfundimtar kontribuojnë edhe frekuentimi, detyrat e kursit, aktivizimi gjatë zhvillimit të ushtrimeve dhe mësimave praktike. Pedagogu informon studentet për rezultatet e çdo kontrolli.</p> <p>Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit që në fillim të procesit mësimor nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës, i cili përmban të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive.</p> <p><i>Evidenca 42 Modele Procesverbale provime, listë notash studenti, vërtetime studenti.</i></p> <p><i>Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i></p> <p><i>Evidenca 53 Plan program i lendeve Topografi GIS.</i></p> <p><i>Evidenca 46 Rregullore e Fakultetit të Inxhinierise dhe Arkitektures</i></p> <p><i>Evidenca 60 Rregullore e provimeve.</i></p> <p><i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Rregullorja e provimeve (evidenca 60) ka të përcaktuara saktë procedurat e kryerjes se provimit. Testimi dhe vlerësimi i dijeve bëhet duke u ruajtur anonimat i studentit. Vetëm pas vlerësimit të komisionit bëhet nga sekretaria dekodimi i testeve ku njihet edhe emri i studentit.</p> <p>Kriteret, kërkesat dhe procedurat që shërbejnë për testimin e aftësive të studentëve parashikohen në rregulloren e përgjithshme të UMT-se dhe rregulloret e provimeve, si dhe ne</p>

<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>rregulloret e tjera në plotësim të saj.</p> <p>Për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmit, UMT aktualisht po zbaton një projekt pilot sistemin “cleanscore” për korrigjimin e provimeve nëpërmjet sistemeve elektronike sipas një rregulli që ruan konfidencialitetin dhe rrit shpejtësinë kontrollit të testeve, në kuadër të marrëveshjes me Albanian American Development Foundation dhe UMT-se. Në vitet në vazhdim pritet që ky sistem të përfshihet dhe në fakultetet e tjera të UMT.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar i studenteve bëhet në provimin e lëndës që zhvillohet gjatë sezonit të provimeve, sipas kalendarit të provimeve, i cili ka të përcaktuar komisionin e provimit të lëndës, auditorin, datën dhe orën e zhvillimit</p> <p>Procedura e vlerësimit të dijeve është transparente, bëhet sipas rregullave të përcaktuara për të cilat studentët janë në dijeni që me përpara. Vlerësimi bëhet me pikë në formë analitike. Për kontrollet e të gjitha niveleve studentet informohen dhe mund të kërkojnë rishikimin e rezultateve në përputhje me rregulloren specifike të provimeve.</p> <p><i>Evidenca 60 Rregullore e provimeve</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i studenteve bëhet në provimin e lëndës që zhvillohet gjatë sezonit të provimeve, sipas kalendarit të provimeve, i cili ka të përcaktuar komisionin e provimit të lëndës, auditorin, datën dhe orën e zhvillimit</p> <p>Procedura e vlerësimit të dijeve është transparente, bëhet sipas rregullave të përcaktuara për të cilat studentët janë në dijeni që me përpara. Vlerësimi bëhet me pikë në formë analitike. Për kontrollet e të gjitha niveleve studentet informohen dhe mund të kërkojnë rishikimin e rezultateve në përputhje me rregulloren specifike të provimeve.</p> <p><i>Evidenca 60 Rregullore e provimeve</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5</p> <p>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim të njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, takimeve me stafin akademik dhe përgjegjës të departamentit, GVJ konfirmon se mënyra e hartimit të programit të studimit Topografi GIS dhe përmbajtja e programeve (syllabuseve) të studimit garanton përfitim maksimal të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit “Topografi dhe GIS”, në përputhje me kornizën Shqiptare të kualifikimit niveli 5, pasi ofrojnë njohuri të thelluara praktike dhe profesionale.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton</p>	

<p>njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Institucioni ka prioritet të vecantë lidhur me zhvillimin e praktikës profesionale në subjektet, aktiviteti i të cilave përputhet me natyrën e programit të studimit që i jep mundësi studentit të avancojë njohuritë dhe aftësitë profesionale. Njohuritë që ofrohen nëpërmjet këtij programi dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, pritet që tu mundësojnë atyre punësimin në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës, si dhe ndjekjen e një karriere profesionale të suksesshme.</p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga dosja e VV dhe takimet e zhvilluara në institucion, GVJ evidenton faktin se në UMT, mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve.</p> <p>Duke patur parasysh natyrën e programit, praktika në terren zëne një vend shumë të rëndësishëm si formë e mësimdhënies. Në kuadër të Erasmusit studente dhe staf i UMT kanë përfituar nga eksperiencat ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Universiteti, tregon vemendje të veçantë lidhur me interaktivitetin dhe bashkëveprimin me studentët, si një proces periodik e i përhershëm që zhvillohet në të gjitha lëndët. Nga takimi me studentët, GVJ kuptoi se ata ndihen të lirë dhe të motivuar për të pyetur për çdo paqartësi lidhur me oret e leksionit/seminarit apo të kërkojnë këshillime për çdo ide të tyre për inovacion apo zhvillim të zgjidhjes së problemit</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Në syllabuse janë hollësisht të përshkruara objektivat dhe kompetencat (outcomes) të çdo lëndë. Këto objektiva u bëhen të njohura studenteve që në fillim të semestrit.</p> <p><i>GVJ, duke marrë në konsideratë faktin që universiteti është në momentin e duhur për rishikimin e kurrikulës (referuar akteve ligjore dhe nënligjore, ku IAL nuk mund të bëjë ndryshime në kurrikul pa kaluar procesi i akreditimit të programit), pas testimit real të planit mësimor të licensuar, GVJ rekomandon/sugjeron që nga UMT të shihet mundësia që:</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p><i>në lëndën “Gjeodezia 2” të përfshihen temat e trajtuar në lëndën “Aplikacione dhe GIS”, si dhe të bëhet ndryshimi i emërtimeve të lëndëve në planin eksistues nga “Modelim dhe projektim GIS” në “Bazat e Sistemeve të Gjeoinformacionit” dhe nga “Aplikacione në GIS” në “Modelime në GIS” duke riformuluar dhe syllabuset përkatëse.</i></p> <p>UMT ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë</p>

	<p>të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Studentet e programit dyvjeçar të “Topografisë dhe GIS” kanë në program realizimin e punimit të diplomës i cili është i planifikuar të realizohet në fund të semestrit të katërt (pra në fund të vitit të dytë). Tema e diplomës përzgjidhet që në fillim të semestrit të katërt. Tematika e diplomës është rezultat i zgjedhjes së studentit. Departamenti cakton një udhëheqës shkencor që është dhe njohës i fushës së temës. Puna për realizimin e temës zgjat një semester dhe i nënshtrohet konsultimeve dhe kontrolleve nga udhëheqësi i temës por edhe nga Departamenti. Mbrojtja e temës bëhet përpara një komisioni të propozuar nga përgjegjësi i departamentit dhe të miratuar nga dekani.</p> <p><i>Evidenca 25 Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik në kuadër të erasmus+</i></p> <p><i>Evidenca 26 Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për studentët në kuadër të erasmus+</i></p> <p><i>Evidenca 27 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit, mobilitetit</i></p> <p><i>Evidenca 28 Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT</i></p> <p><i>Evidenca 50 Dosja e programit të studimit profesional 2 vjeçar Topografi dhe GIS, të dhëna të përgjithshme.</i></p> <p><i>Evidenca 51 Plani mësimor_Topografi dhe GIS.</i></p> <p><i>Evidenca 52 Plani mesimor sipas llojit të veprimtarisë</i></p> <p><i>Evidenca 53 Plan e lendeve Topografi GIS</i></p> <p><i>Evidenca 54 Ngarkesa në auditore sipas formës së mesimdhënies</i></p> <p><i>Evidenca 55 Rregullore e programit të studimit Topografi dhe GIS.</i></p> <p><i>Evidenca 56 Model i diplomes Topografi GIS</i></p> <p><i>Evidenca 46 Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitektures</i></p> <p><i>Evidenca 60 Rregullore e provimeve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 64 Rregullore e Praktikes</i></p> <p><i>Evidenca 65 Formularet e praktikës</i></p> <p><i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Nga dokumentacioni i DVV, takimet ne institucion, GVJ konstaton se politika e UMT është të tërheqë staf të kualifikuar me tituj e grada shkencore, si dhe staf akademik me eksperiencë në fusha specifike, si garanci për realizimin e misionit të UMT për të diplomuar studentë jo vetëm me formim teorik, por edhe me shprehi dhe aftësi praktike, të gatshëm për të filluar punë në fushën per te cilen janë diplomuar.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik bëhet në bazë të rregullores “Për rekrutimin e personelit akademik të UMT” të miratuar nga Senati Akademik. Kërkesat ndaj stafit akademik, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, gjenden të përputhura me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p>Rekrutimi i stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm i UMT, bëhet me konkurs. Kriteret specifike të konkurimit për të dyja kategoritë bëhen në përputhje me kërkesat ligjore të arsimit të lartë të proceduarve të përcaktuara në UMT, si dhe njohurive dhe kompetencat e plota për mbulimin e lëndës, që duhet të kënenë kandidatët fitues.</p> <p>Procedura e rekrutimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti paraqet Dekanit për miratim kërkesën për plotësim të vendit vakant të punës, duke specifikuar kriteret akademike që duhet të ketë kandidati 2. Dekani ia përcjell Rektorit, i cili më pas shpall konkursin për vendin vakant. Konkursi shpallet dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT. Shpallja e vendeve të lira përmban të gjitha informacionin përkatës për çdo pozicion. 3. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision sipas përcaktimeve në statutin dhe rregulloren e UMT, mbështetur në: a) Dosjen e kandidatit dhe b) intervistën e tij 4. Shpallja e kandidatit fitues, njoftimi i tij dhe lidhja e kontratës së punës. <p><i>Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.</i> <i>Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i></p>

	<p><i>Evidenca 29 UMT Udhëzim mbi politikat e punësimit të stafit akademik në UMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Nga takimi me zyrën e BNP si dhe nga dokumentacioni i DVV, GVJ konstaton se për stafin akademik me kohë të plotë dhe me kontratë të angazhuar në të gjitha programet e studimit, dhe specifiku në programin Topografi GIS, si dhe për stafin ndihmës akademik dhe administrativ, UMT disponon bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, të cilat mblidhen dhe ruhen nga Zyra e Burimeve njerëzore si dhe në departamentin përkatës.</p> <p>Në këto të dhëna përfshihen CV e përditësuar, kualifikime, punimet me të fundit kërkimore shkencore (për stafin akademik), kontrata e punës etj.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.</i> <i>Evidenca 63 FIA Lista e plote e personelit me kohe te plote dhe me kohe te pjesshme</i> <i>Evidenca 29 UMT Udhëzim mbi politikat e punësimit të stafit akademik në UMT.</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentin e paraqitur në DVV dhe në takimin me stafin akademik, në të dhënat për numrin e stafit akademik që mbulon programin e studimit, ngarkesën mësimore në orë për secilin pedagog, si dhe CV akademike e profesionale të tyre, rezultojnë se UMT ka kapacitete potenciale optimale të burimeve njerëzore në përbushje të objektivave të programit të studimit topografi dhe GIS. Referuar të dhënave në tabelat përkatëse.</p> <p>Për të gjithë punonjësit e punësuar në këtë institucion (personel akademik, ndihmës akademik dhe administrativ), trajtohen sipas legjislacionit financiar lidhur me sigurimin shëndetësor dhe shoqëror; të gjithë punonjësit iu janë vënë në dispozicion zyra të dedikuara sipas strukturës ku ata bëjnë pjesë, mjedise të përbashketa etj, auditore mësimi të mirëpajisura, laboratore etj, të cilat krijojnë mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> <p><i>Evidenca 58 CV personeli akademik.pdf</i> <i>Evidenca 68 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës.</i> <i>Evidenca 91 Ambjente per infrastrukture</i> <i>Evidenca 92 Asetet Infrastrukturore akademike</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes</p>	<p>UMT promovon programe specifike, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim, që kanë të bëjnë me sigurimin e të dhënave shkencore përditësimit të materialit didaktik, pjesëmarrjen në konferenca e seminare kombëtare e rajonale, organizim konferencash në institucione, në mbështetje të kualifikimit të</p>

<p>organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>vazhdueshëm të personelit (referencë RVB dhe takimi me stafin drejtues dhe akademik).</p> <p>GVJ, konstaton se UMT, ka synim kualifikimin në mënyrë specifike të stafit, ka politika për nxitjen dhe motivimin e personelit për pjesëmarrje në forume akademike, promovime të krijimeve dhe të botimeve të ndryshme, aktivitete përmblyëse të projekteve kërkimore/studimore, prezantime të veçanta, simpoziume, lektoriume, leksione të hapura, referime shkencore, workshope, shkolla verore dhe konferencat kombëtare/ndërkombëtare. Në kuadër të programit “Erasmus”, stafet akademike përvec kohës së mobilitetit në univiersitete të huaja, marrin pjesë rregullisht në workshope në vende të Bashkimit Evropian.</p> <p>Formë tjetër për kualifikimin e personelit që mbulojnë programet e studimi në UMT, janë metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja si “Edu4school”</p> <p><i>Evidenca 25 UMT Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik në kuadër të erasmus+.pdf</i> <i>Evidenca 27 UMT Lista e universiteteve bashkëpunuese ne kuadër të shkëmbimit, mobilitetit.</i> <i>Evidenca 28 UMT Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT.</i> <i>Evidenca 36 UMT Plan Pune 2019</i> <i>Evidenca 69 FIA_Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve</i> <i>Evidenca 72 FIA_Minuta të mbledhjeve të dekanatit</i> <i>Evidenca 86 FIA Raporti për metodat inovative në procesin e mësidhënies</i> <i>Protokolli i takimeve në institucion</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të</p>	<p>UMT siguron mjediset për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në funksion të të gjitha programeve të studimit që ofron. UMT kryen dhe zhvillon veprimtarinë akademike dhe administrative në 2 godina. Godinat janë të ndërtuara vitet e fundit, me materiale cilësore të standardeve ISO, brenda standardeve të</p>

<p>programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>kërkuara nga autoritetet përkatëse (refrence RVB dhe vizita në ambientet e UMT), si me poshtë:</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Godina 1 me 2347 m² – Godina 2 me 2490 m² <p>Nga takimet me personelin administrativ, ishte Zyra e Financës struktura që disponon inventarët e aseteve të institucionit, si dhe planifikon dhe realizon, në përputhje me buxhetin e miratuar, sipas udhëzimeve përkatëse, shtimin dhe përmirësimin e tyre, sipas zërave konkretë.</p> <p>Nga takimi me studentet, u evidentua fakti se procesin mësimor e realizojnë në orare të përshtatshëm, u krijojnë mundësi për të shfrytëzuar maksimalisht kohën për të studiuar apo punuar në bibliotekë, si dhe u vihen në dispozicion cdo ambient tjetër për çfarë kanë nevojë.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Godina ku zhvillon procesin mësimor, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitektures (njësia kryesore që ofron programin Topografi dhe GIS) është rreth 2674 m², ose nëse i referohemi numrit të studentëve të këtij fakultetit rezulton 8.9 m² për studente, sipërfaqe optimale në dispozicion të studentit.</p> <p>Në këto godina gjenden auditore për zhvillimin e leksioneve, salla seminaresh, laboratore të lëndëve të shkencave natyrore, laboratore informatike (6 laboratore informatike) si dhe biblioteka.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>UMT ka një infrastrukturë të përshtatshme: klasat/auditoret janë të plotësuara me pajisjet me të fundit të teknologjisë, duke mundësuar proces mësimor në standarde bashkëkohore. Për aftësimin praktik të studentëve, në lëndë të vecanta janë parashikuar që zhvillimi i orëve mësimore të mbështetet dhe nga laboratorë të pajisur me kompjuterë personale dhe me internet.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>Në laboratorët e informatikës janë të instaluar edhe software që i shërbejnë zhvillimit të disiplinave mësimore të përgjithëshme Autocad dhe programe të afërta me të si dhe zhvillime të tij si Arcgis, Automap, Autocad 3D, ashtu dhe software krejtësisht të specializuara QGIS.</p> <p>Ambientet ku zhvillohet mësimi dhe zyrat janë të ndriçuara maksimalisht, me mbi 20% ndriçim natyral, me akustikë, me sistem individual kondicionimi me inverter për ngrohje dhe ftohje.</p> <p>Sallat janë të pajisura me projektorë, me qasje në internet nga çdo vendndodhje në sipërfaqen e godinës që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik</p> <p>Klasat janë të pajisura me kompjuter për të zhvilluar komponentët mësimorë dhe praktik të topografisë dhe GIS-it. Kompjuterat, projektorët, interneti, janë të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor të studentëve. Universiteti ka të organizuar shërbimin IT, ku specialiste të fushës së informacionit ndihmojnë jo vetëm në mirëfuksionimin e rrjetit</p>

	<p>të internetit por edhe në inkludimin e noviteteve në praktiken didaktike.</p> <p>Në laboratorët e informatikës janë të instaluar edhe software që i shërbejnë zhvillimit të disiplinave mësimore të përgjithëshme Autocad dhe programe affine me të si dhe zhvillime të tij si Arcgis, Automap, Autocad 3D, ashtu dhe software krejtësisht të specializuara QGIS.</p> <p>Në ambientet e UMT janë vendosur laboratorët e informatikë, laboratorit multi funksional, laboratorët e teknologjisë së materialeve të ndertimit, laboratorit i gjeoteknikës, laboratorit i shkencave të natyrës, etj. që i bëjnë të mundur studentit të sigurojë dhe të përdorë informacionin e marrë në funksion të lëndëve/moduleve përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 44 UMT Platforma për mësimin online</i> <i>Evidenca 45 UMT Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.</i> <i>Evidenca 84 FIA Orari mesimore.</i> <i>Evidenca 91 FIA Ambjente për infrastrukture</i> <i>Evidenca 92 FIA Asetet Infrastrukturore akademike</i> <i>www .umt.edu.al</i> <i>Evidenca 93 Relacion Biblioteke</i> <i>Protokolli i takimeve në Institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi IV.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u pa biblioteka e “Universitetit Metropolitan Tirana”, e cila ofronte kushte për akses të barabartë e pa pagesë për të gjithë studentët. Biblioteka ishte e pajisur me PC, ku mundësohej përdorimi i literaturës elektronike pa kufizim nga studentët, si dhe i programeve kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që gjendeshin të instaluar, programe këto që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime për detyra kurse, punime diplmash etj, sipas profileve të programeve.</p> <p>Refeuar RVB, Rregullores së UMT, rregullores së bibliotekës dhe takimeve të zhvilluara, rezulton se:</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën</p>	<p>Biblioteka e UMT ofron shërbim falas për studentët, personelin</p>

<p>shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>mësimdhënës e administrativ, si dhe persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës. Bazuar në rregulloren e UMT-së biblioteka shkencore e Universitetit është bibliotekë publike që mund të përdoret edhe nga lexues të tjerë. Ajo ka në fondin e saj tekste mësimore bazë si dhe libra e revista në gjuhën shqipe dhe të huaj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Biblioteka e UMT ka në dispozicion të studentëve të këtij programi tekste mësimore të hartuara nga pedagogët e tij si dhe nga pedagogët më me emer të universiteteve të tjera në vend. Po ashtu, edhe leksionet e shkruara zënë një vend të konsiderueshëm për lëndët dhe kurrikulat e reja. Përpjekje paraprake janë bërë edhe për sigurimin e literaturës ndihmëse cilësore. Librat janë de facto në dispozicion dhe numri i kopjeve është i mjaftueshëm në raport me numrin e studentëve të regjistruar.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>“Universiteti Metropolitan Tirana” ofron aplikacionin “edu4school”. Nëpërmjet këtij aplikacionit studentit i mundësohet aksesin në leksione dhe materialet e ndryshme didaktike që janë në përputhje me syllabuset lëndore të Universitetit dhe tekste bashkëkohorë. Studentet konsultohen me leksionet në kohë reale.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Për programin e studimit Topografi dhe GIS, UMT garanton më logjistikën e nevojshme si për formimin teorik ashtu dhe praktik të studnetëve. UMT ka në prioritetet e tij rritjen e numrit të bashkëpunimeve përveç me IAL vendase dhe të huaj, edhe me kompani/biznese sipas profileve specifike të programeve të studimit që ofron ky institucion.</p>
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Institucioni planifikon fonde të mjaftueshme për programin e studimit profesional, ku parashikohet mbështetja financiare e nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. UMT harton raportin financiar të përvitshëm. [Ev 101, 70]. Burimet e financimit të UMT janë nga fondet dhe kontributet e themeluesve, të ardhurat nga tarifa e shkollimit që paguan çdo student në bazë të tarifave të miratuara dhe nga projektet e fituara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, nga shërbime për të tretë të ofruara nga UMT. Referuar RVB, veprimtaria ekonomike e UMT pasqyrohet në dokumentacionin financiar të detyruar për t’u plotësuar dhe dorëzuar në organet e tatim-taksave sipas legjislacionit financiar në fuqi.</p> <p>Administratori i UMT përgjigjet për realizimin e planit financiar dhe raporton në Bordin e Lartë Drejtues për veprimtarinë ekonomike-financiare.</p>
	<p><i>Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 44 Platforma për mësimin online</i></p>

	<p><i>Evidenca 70 Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar</i></p> <p><i>Evidenca 93 Relacion Biblioteke.</i></p> <p><i>Evidenca 94 Lista e botimeve</i></p> <p><i>Evidenca 101 Shpenzimet dhe te ardhurta FIA ne 3 vitet e fundit tabela</i></p> <p><i>Evidenca 27 Lista e universiteteve bashkëpunuese ne kuadër të shkëmbimit, mobilitetit.</i></p> <p><i>Protokolli i takimeve në Institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumnetacionin e DVV, takimet në institucion konstaton se:</p> <p>UMT harton, zbaton dhe publikon, politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë programit të studimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UMT, Rregulloren e FIA, Rregulloren specifike të programit të studimit Topografi dhe GIS, pranohen për t'u regjistruar në programin e studimeve me karakter profesional Topografi dhe GIS shtetasit shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë këto kushte:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zotërojnë diplomë të shkollës së mesme (Maturë shtetërore) së bashku me listën e notave. • Për të huajt, dëshmi e njohjes së gjuhës shqipe dhe diplomë të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga struktura përgjegjëse. Ky ekuivalentim kërkohet edhe për ata studentë shqiptarë që kanë përfunduar studimet jashtë shtetit. • Kryejnë pagesën e tarifës së shkollimit sipas kushteve dhe përcaktimeve në kontratën elidhur me studentin.
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e</p>	

<p>profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimi të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Referuar Vendimeve të Seantit Akademik (në DVV) për kriteret e kuotat dhe kriteret e pranimit, përzgjedhja e kandidateve bazohet në kriteret e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë, dhe të meritës që nënkupton vlerësim tërësor të treguesve të kandidatit. Procesi i përzgjedhjes së programit nga kandidatët organizohet nga UAlbania sipas kuadrit ligjor në fuqi për arsimin e lartë. Rankimi i kandidateve bëhet nga UMT, bazuar mbi notën mesatare të arsimit të mesëm të secilit aplikant.</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Suipas statutit të UMT, kandidati fiton statusin e studentit dhe ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të Universitetit brenda afateve kohore të përcaktuara paraprakisht dhe të shpallura. Përzgjedhja e kandidateve bëhet në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara në përputhje me kapacitete akademike dhe infrasrukturore të UMT .</p> <p>Çdo student i regjistruar në UMT pajiset me numër matrikullimi. Studenti e humbet statusin e tij me marrjen e diplomës, me largimin vullnetar të tij pa përfunduar studimet ose me përjashtimin e tij nga Universiteti.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ-së iu konfirmua dhe gjatë takimeve se: UMT vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimi të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit. Këtu bën pjesë edhe formimi praktik e profesional i studentëve, me anë të realizimit të procesit të mësimave praktike, praktikave profesionale të mbikëqyrura, etj. Secili nga këto elementë konsiderohet si detyrim kurrikular. Studenteve ju është dhene akses i plotë mbi dokumentacionin e lëndëve/moduleve, përmbajtjen e tyre si dhe aktiviteteve formuese të ndërlydhura.</p>
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Ne UMT studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, me anë të formave të disponueshme elektronike, hard copy, broshura, konsultimeve me kordinatorët e programeve, stafin akademik etj., Ata informohen po ashtu në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studenti i regjistruar e merr informacionin dhe nëpërmjet platformës elektronike si edu4school.</p> <p>Informacion i detajuar për programet gjenden në departament, në guidën e studentit, të publikuara online si dhe në portalin e studentit, i ndarë sipas lendeve përkatëse.</p> <p>UMT dukshëm ofron në shërbim të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar</p>

mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, kjo falë meanxhimit të sistemit të informimit.

Është zyra e këshillimit të karrierës dhe e shërbimit ndaj studentëve njësia përgjegjëse, e cila në bashkepunim dhe me njesite e tjera akademike (departamentt/fakultet), informojnë, orientojnë dhe këshillojnë studentët për mundësitë e punësimit bazuar në rregulloren e sektorit të marketingut, Alumnit dhe karrierës.

Në UMT informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet në disa forma: përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit (*edu4school*), shërbimeve “Suport ndaj studentit” ose “Shërbimi i studentit”, sekretarise mësimore on line, faqes zyrtare të UMT (www.umt.edu.al), Zyra e karrierës etj.

Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana

Evidenca 46 Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitektures.

Evidenca 82 Shembull dosje studenti të regjistruar

Evidenca 85 Rregullore e Sekretarisë

Evidenca 44 Platforma për mësimin online

Evidenca 45 Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.

Evidenca 51 Plani mësimor_Topografi dhe GIS

Evidenca 55 Rregullore e programit të studimit Topografi dhe GIS

Evidenca 100 Faqa ËEB dhe rrjetet sociale

Evidenca 31 dhe 32 Kuotat e pranimit në programet e ciklit të I dhe të integruar të ciklit të dytë miratuar me VSA

Evidenca Raporti MASR mbi çertifikimin e kuotave të pranimit në UMT, viti akademik 2019-2020

Evidenca 34 Publikimet në ëeb të UMT të njoftimeve për pranimet.

Evidenca 35 Relacion statistikorë mbi aplikantët në UMT 2019-2020

Evidenca 98 UMT Rregullore e arkivës

Evidenca 101 Shpenzimet dhe të ardhurta FIA në 3 vitet e fundit

Evidenca 102 Rregullore e provimeve

Evidenca 49 Guida e studentit.

Evidenca 77 Rrjeti Alumni dhe aktivitete.

Evidenca 74 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës

Evidenca 73 Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT

Evidenca 83 Plani i Marketingut UMT

www.umt.edu.al

Protokoll i takimeve në Institucion

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Nga dokumentacioni i DVV, takimet me stafin akademik, studentët, stafin administrativ GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan Tirana, përdor dhe zhvillon vazhdimisht sistemet e informimit. UMT disponon sistemin e tij funksional <i>edu4schools</i> , të përshtatur me të gjitha elementet e specifikat që ka UMT dhe programet që ofron.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Gjithashtu referuar RVB dhe takimeve të zhvilluara, UMT është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) dhe QSHA, nëpërmjet platformave që ofrojnë këto struktura realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit on-line të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e UMT-së, si dhe matrikullimi i studentëve bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UMT-ja. Gjithashtu, UMT përdor shërbimet e ASCAL Management System (AMS) nëpërmjet të cilit administrohen dhe menaxhohen të gjitha informacionet elektronike që lidhet me të dhënat e institucionit, strukturën akademike, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen në kohë reale.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Faqja zyrtare e UMT, pasqyron veprimtarinë administrative, institucionale, akademike, kulturore e sociale, jep informacion lidhur me dokumentet rregullative të institucionit, vendime të Senatit Akademik (miratim kriteresh, kuota, afate aplikimi regjistrimi të studentëve etj.), ciklet dhe programet e studimit, organigrami, njoftime/thirrje për projekte etj. Në faqen e UMT, informacionet që lidhen me programin e studimit, planin mësimor, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, janë në dy gjuhë: gjuhë shqipe dhe angleze
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Rrjetet sociale, janë një tjetër mënyrë komunikimi që përdor institucioni. Komunikimi i brendshëm kryhet nëpërmjet postës elektronike me domain të institucionit@umt.edu.al , me të cilin është pajisur i gjithë stafi akademik e administrativ, si dhe studentët (<i>reference RVB dhe takimeve në institucion</i>)
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Të gjitha metodat e përdorura të ruajtjes dhe shkëmbimit të informacionit administrohen nga personi përgjegjës i sektorit të
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	

teknologjisë dhe informacionit në nivel rektorati si dhe nga drejtoria e komunikimit, të cilët janë njëkohësisht përgjegjës për sigurinë e informacionit dhe ruajtjen e tij (*reference RVB dhe takimeve ne institucion*).

Në UMT-së ka rrjet të brendshëm të lidhur me internet për stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe studentët.

Institucioni ka siguruar për punonjësit akademik dhe jo akademik infrastrukturën harduerike të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij, si pajisje kompjuterike dhe shërbime interneti, pajisje të tjera të rëndësishme si printer, fotokopje, skaner, etj.

Institucioni, menaxhon një ciklël të plotë të një studenti: regjistrimin, vlerësimet e studentit deri në diplomim, transferimin e studimeve të studentit, pagesat etj, në format hard copy dhe elektronik (*nëpëmjet sistemit edu4schools*).

Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana

Evidenca 46 Rregullore e Fakultetit te Inxhinerise dhe Arkitektures.

Evidenca 20 Print Screen i faqes së ASCAL.pdf

Evidenca 39 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.

Evidenca 40 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve.

Evidenca 41 Ndërfaqja, administratori, pedagogu, sekretaria, studenti.

Evidenca 42 Modele Procesverbale provime, listë notash studenti, vërtetime student

videnca 43 Print Screen të faqes ëeb lidhur me veprimtarinë kërkimore shkencore

Evidenca 85 Rregullore e Sekretarisë

Evidenca 44 Platforma për mësimin online

Evidenca 45 Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.

Evidenca 91 Ambjente per infrastrukture

Evidenca 55 Rregullore e programit te studimit Topografi dhe GIS

Evidenca 100 Faqa ËEB dhe rrjetet sociale

Evidenca 34 Publikimet në ëeb të UMT të njoftimeve për pranimet.

Evidenca 49 Guida e studentit.

Evidenca 77 Rrjeti Alumni dhe aktivitete.

Evidenca 74 Aktivitetet e Zyrë së Karrierës

Evidenca 73 Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT

Evidenca 83 Plani i Marketingut UMT

Protokoll i takimeve në Institucion

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
-------------------------------------	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>UMT është përgjegjëse për përcaktimin e kuotave dhe kriterëve përzgjedhëse në të gjitha programet e studimit që ofron dhe, për këtë qëllim ka hartuar dhe zbaton një sërë aktesh rregullatorë.</p> <p>Në këtë kuadër, pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kuotat dhe kriteret e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit, procedurën e pranimeve në vitin akademik dhe Udhëzimet që nxjerr MASR.</p> <p>Kriteret specifike të pranimit dhe numri i kuotave në programin e studimit “Topografi dhe GIS” propozohen nga Departamenti Inxhinierisë së Ndërtimit dhe miratohen nga Dekanati i FIA. Në planifikimin e kuotave të pranimit për vit akademik, merren në konsideratë kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të UMT. Pas miratimit të tyre në Senatin akademik të UMT-së, përcillen për certifikim nga MASR</p> <p>I gjithë informacioni i mësipërm, bëhet publik në faqen zyrtare të UMT dhe në rrjetet sociale të universitetit, veçanërisht kriteret dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, si dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi. Universiteti nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për studentë. Prej vitesh, UMT nëpërmjet komisioneve <i>ad-hoc</i> të përbëra me përfaqësues nga çdo fakultet dhe sistemeve informatike që përdor, ka zhvilluar procedurat më të drejta të përzgjedhjes së studentëve që regjistrohen në ciklin e parë të studimeve dhe në ciklin e dytë</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatorë, procedura të</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin,</p>	

<p>procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>miratuara e të bëra publike.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>I gjithë dokumentacioni i administrimit, procedurat, rregulloret etj, janë të publikuara në faqen zyrtare të universitetit. Ndërkohë studentët, personalisht ose nëpërmjet qeverise studentore, mund të gjejnë informacionin e duhur në fakultet, departamente dhe në çdo strukturë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në përputhje me aktet rregullative në fuqi, institucioni e kryen në disa drejtime informimin sa më të gjerë në lidhje me programin e studimit dhe kriteret e veçanta për tu pranuar dhe në bashkëpunim me Fakultetet e UMT, me KS dhe zyrën e karrierës organizojnë aktivitete informuese për kandidatët apo familjarë të tyre në mjediset e UMT. Në këto aktivitete bëhen prezantime rreth organizimit të studimeve, të drejtave dhe detyrimeve të studentëve, informacione mbi kontaktet e nevojshme, njohjen me të gjitha ambientet fizike të fakultetit apo të universitetit. Guida e studentit është material që ka informacionin e nevojshëm që duhet të ketë studenti në fillim të vitit akademik, veçanërisht informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, infrastrukturën laboratorike dhe shërbimet e tjera që përfitojnë studentët në FIA.</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Këshilli Studentor, nga ku studentët mund të marrin informacion edhe nga strukturat e tyre të zgjedhura si senatorët e klasave, zyra e karrierës, përfaqësuesit e tyre në organet drejtuese të universitetit etj. (rregullore e KS), Orientimi dhe këshillimi i studentëve në nivel institucional kryhet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, Shërbimi ndaj Studentit e të tjera zyra administrative. Ata trajtohen nga këto organe administrative që nga momenti i pranimit, gjatë zhvillimit të studimeve, si dhe pas diplomimit, duke krijuar kështu rrjetin Alumni. Gjithashtu, në funksion të mbështetjes akademike dhe sociale, çdo programi studimi i është caktuar një koordinator programi, i cili kujdeset për të gjitha ankesat/ kërkesat/ mentorimet për studentët e programit specifik, me karakter akademik ose jo. Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të huaj, në përputhje me udhëzimet e MASR-it, ku përcaktohen procedurat e aplikimit të shtetasve të huaj që dëshirojnë të jenë pjesë e UMT-së, si dhe kuotat përkatëse. Në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së studentëve të huaj janë të njëjta si studentët shqiptarë por, deri tani nuk është aplikuar ndonjë procedurë rekrutimi e studentëve të huaj. Aktualisht programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe, por në rast të aplikimeve nga studentë të huaj, lehtësisht UMT mund të ofrojë programin dhe në gjuhën angleze, bazuar në kapacitet akademike dhe në eksperiencën e ofrimit të disa programeve në gjuhë angleze.</p>
	<p>UMT ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të</p>

	<p>veçanta të studentëve, si komuniteti rom dhe egiptian, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me të ardhura të pakta ekonomike, duke parashikuar kuota pranimi në programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi. Për secilën kategori janë paracaktuar kriteret për përfitimin e bursave deri në masën 100%.</p> <p>Krahas programit të bursave për kategori të ndryshme, për studentët aktivë ofrohen internshipe dhe punësim pranë institucionit ose partnerëve të tij. Veprimtaria jashtë shkollore në kontribut për institucionin ju vlerësohet studentëve orë pune, duke ju reduktuar tarifën e studimit. Misioni i institucionit është tërësisht i orientuar drejt punësimit të ardhshëm të studentëve të tij. Në funksion të këtij misioni, institucioni ka krijuar të parin inkubator in Campus, i cili operon prej 3 vitesh tashmë, duke inkubuar idetë më të mira dhe duke ofruar trajnime dhe ekspertizë nëpërmjet organizimeve të bootcampeve.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 30 UMT Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.</i> <i>Evidenca 31 Kuotat e pranimit në programet e ciklit të I dhe të integruar të ciklit të dytë miratuar me VSA.</i> <i>Evidenca 33 Raporti MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT, viti akademik 2019-2020.</i> <i>Evidenca 49 UMT Guida e studentit.</i> <i>Evidenca 82 FIA Shembull dosje studenti te regjistruar.</i> <i>Evidenca 88 FIA Aktivitete të kryera nga studentët qeveri studentore UMT-FIA.</i> <i>Evidenca 91 FIA Ambjente per infrastrukture UMT FIA tabela 16.</i> <i>Evidenca 92 FIA Asetet Infrastrukturore akademike.</i> <i>Evidenca 95 UMT Politikat e Bursave</i> <i>Protokolli i takimeve në Institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi

<p>Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Në UMT, studentët informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, njësia bazë përgjegjëse së bashku me dekanatin organizojnë takime informuese dhe të përshtatjes me fakultetin, ku atyre ju shpjegohen në detaje përbërja e UMT-së, struktura e tij, objektivat dhe strategjia, përbërja dhe struktura e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, drejtuesit dhe stafi i tij, përgjegjësit e departamenteve etj. Gjithashtu bwhet edhe prezantimi me infrastrukturën, bibliotekën, laboratorët dhe kushtet në të cilat do të realizohet ky program studimi. UMT përdor platformën mësimore <i>Edu4school</i> ku studente marrin informacionin e plotë për gjithë zhvillimin e procesit mësimor, mungesat, materialet didaktike, leksionet, rezultatet e kontrolleve etj. Studentët informohen edhe nëpërmjet planit mësimor për strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Informacion i plotë dhe i përditësuar për strukturën institucionale dhe programet e studimit mundësohen nga faqja zyrtare e universitetit si dhe nga mediat sociale (Facebook, Twitter, LinkedIn, etj).</p>
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Këtij qëllimi i shërbejnë dhe këshilltarët akademikë. Këshilltarët akademikë janë pedagogë të departamentit që mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentët, në mënyrë periodike, informojnë studentet për programin mësimor, për kalendarin akademik, për rregulloret e programit të studimit, për vendimet e ndryshme të Senatit Akademik etj., dëgjojnë problemet që mund të kenë studentët dhe përpiqen të japin zgjidhje nëpërmjet konsultimeve në departament. Studentët për problemet e tyre mund ti drejtohen edhe shërbimit të studentit si dhe suportit të studentit.</p>
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Guida e studentit, nëpërmjet takimeve me stafin akademik etj.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.</i> <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 34 Publikimet në web të UMT të njoftimeve për pranimet.</i> <i>Evidenca 44 Platforma për mësimin online</i> <i>Evidenca46: Rregullore e Fakultetit të te Inxhinierise dhe Arkitektures</i> <i>Evidenca 49 Guida e studentit</i> <i>Evidenca 55 Rregullore e programit te studimit Topografi dhe GIS</i> <i>Evidenca 53 Plan programet e lëndëve. Pdf</i> <i>Evidenca 76 Vendim per percaktimin e koordinatorve te programeve te studimit FIA</i></p>

	<i>Evidenca 100 Faqa WEB dhe rrjetet sociale</i> <i>Protokolli i takimeve në Institucion</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	UMT disponon të dhëna sipas viteve për studentët që kanë aplikuar, numrin e studentëve që vazhdojnë studimet dhe studentëve të diplomuar për programet e tjera, ndërsa për programin e studimit profesional Topografi dhe GIS, nuk ka të diplomuar, pasi ky është brezi i parë që pritet të dalët. Të dhënat për studentët e regjistruar, të diplomuar, kalueshmeria në vite gjenden pranë sekretarisë mësimore. Sekretaria mësimore disponon dosjet për çdo student, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e maturës shtetërore, listë notash, kontrata dhe aneks kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, dy fotografi.
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ-së ju vunë në dispozicion regjistri themeltar, regjistri i rezultateve të arritura nga studentet të programit Topografi dhe GIS, të cilët rezultuan të plota dhe në përputhje me kërkesat ligjore për to. Të dhënat në regjistrat e sipërcituar janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme vetëm nga personat e autorizuar, në përputhje me aktet normative të ruajtjes së të dhënave personale dhe të dhe të UMT-së.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.	Të dhënat statistikore, për programin e studimit Topografi dhe GIS, menaxhohen nga sekretaria mësimore e FIA-së dhe UMT. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar etj., bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e UMT-së. Statistikat e përgatitura ruhen në formë elektronike dhe hard-copy dhe përdoren si për analiza të aspekteve specifike ashtu dhe në kuadër të raportit vjetor në nivel fakulteti dhe universiteti.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Referuar DVV, RVB dhe takimeve në insitucion rezulton se UMT-ja periodikisht harton dhe analizon raporte të detajuara
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	

	<p>mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Sekretaritetë mësimore bëjnë raportet mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI dhe Shërbimit ndaj Studentit, informon lidhur me shkallën e punësimit të studentëve sipas programeve të studimit. Drejtoria e komunikimit dhe marrëdhënieve me jashtë, është njësi që analizon punësimin e studentëve të diplomuar sipas programeve të studimit, ofron shërbim të plotë të menaxhimit të karrierës, mbështetje në kërkimet e punësimit gjatë të gjithë periudhës së studimit, njoftime punësimi periodike, këshillim i personalizuar i karrierës si dhe ndihmë konkrete rreth mënyrës së kërkimit të punës dhe përgatitjes së CV dhe dokumenteve të tjerë të rekrutimit.</p> <p><i>Evidenca 70 Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar</i></p> <p><i>Evidenca 46 Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitektures</i></p> <p><i>Evidenca 73 Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT</i></p> <p><i>Evidenca 74 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës.</i></p> <p><i>Evidenca 75 Shembull_Java e orientimit_FIA.</i></p> <p><i>Evidenca 81 Model_Regjistri i pedagogut studentit</i></p> <p><i>Evidenca 83 Plani i Marketingut UMT</i></p> <p><i>videnca 85 Rregullore e Sekretarisë.</i></p> <p><i>Evidenca 98 Rregullore e arkivës.</i></p> <p><i>Evidenca 82 Shembull dosje studenti të regjistruar</i></p> <p><i>Evidenca 35 Relacion statistikorë mbi aplikantët në UMT 2019-2020.</i></p> <p><i>Evidenca 42 Modele Procesverbale provime, listë notash studenti, vërtetime studenti.</i></p> <p><i>Evidenca 59 Numri i studentve të regjistruar për herë të parë në FIA në 5 vite,</i></p> <p><i>Protokolli i takimeve në Institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet</p>	<p>Në UMT, studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse të institucionit sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.</p>

<p>vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Referuar RVB, dokumentacionit në DVV si dhe në takimet e zhvilluara, GVJ konfirmon se studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: Senatin Akademik dhe në komisione të përhershme si NJBSC dhe në Këshillin e Etikës, sipas përcaktimeve në statutin e UMT-së dhe rregulloret e ndryshme nëpërmjet të cilave është garantuar përfaqësimi i studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në UMT, funksion Këshilli studentor i UMT (KS UMT), i cili është organ kolegjal, me përfaqësues të zgjedhur nga vetë studentët. KS ka rregulloren e tij, ka komunikim institucional me strukturat e tjera në UMT për të përcuar në mënyrë e drejtpërdrejtë e për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Aktivitetet e KS mbështeten në forma të ndryshme nga ana e institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Studentët e UMT-së, shprehin mendimet e tyre për procesin mësimor dhe për aspekte që lidhen konkretisht me studentin, nëpërmjet vlerësimeve semestrale, takimeve informale, nëpërmjet zyrës së shërbimit ndaj studentit etj,</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në dokumentat rregullative në nivel universiteti, fakulteti dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit në Topografi dhe GIS është parashikuar procesi i transferimit të studimeve (njohje të pjesshme ose e plotë e studimeve) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për këtë aspekt. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton që, institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Tërheqja e mendimeve bëhet nga departamenti/fakulteti/NJSBC, si gjatë diskutimit të planeve mësimore në fazat e miratimit të tyre ashtu dhe në fund të semestrit kur analizohen aftësitë dhe kompetencat e marra gjatë lëndës dhe problemet që janë evidentuar, kjo e sanksionuar në hirarkine e akteve rregullative të institucionit (Rregullore UMT/Fakulteti/Programi, Rregullore NJSBC etj)</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Përsa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, UMT zbaton rregullat e përcaktuara në rregulloren e UMT, në rregulloren e provimeve. Nëpërmjet procedurave të sanksionuara në këtë dokumentacion synohet të sigurohet ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë këtu mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit, njësisë dhe pedagogut përgjegjës. Në këtë kontekst, GVJ eidenton faktin që UMT në kuadër të projektit me AADF, po implementon sistemin cleanscore, për korrigjimin e provimeve në formë elektronike.</p>
	<p><i>Evidenca 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.</i> <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 8: Përbërja e NJSBC-së,</i></p>

	<p><i>Evidenca 9 Rregullore e NjsBC</i> <i>Evidenca 7 VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidenca 12: Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT-së</i> <i>Tabela 24: Të dhëna për anëtarët e NJSBC-së</i> <i>Evidenca 60: Rregullore e provimeve.</i> <i>Evidenca 46: Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës</i> <i>Evidenca 50 Dosja e programit të studeimit profesional 2 vjecar Topografi dhe GIS, të dhëna të përgjithshme.</i> <i>Evidenca 55: Rregullore e programit të studimit</i> <i>videnca 88 _Aktivitete të kryera nga studentët _keshilli studentor</i> <i>Evidenca 89 Rregullore e Kwshillit Studentor UMT</i> <i>Evidenca 90 Shëmbull, kërkesa të ndryshme të Këshillit Studentor FIA</i> <i>Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete</i> <i>Protokolli i takimeve në Institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ konfirmon se Universiteti Metropolitan Tirana ka struktura të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Në shërbim të informimit e kujdesit ndaj studentëve në UMT, funksionojnë: Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, njësia bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit Topografi dhe GIS.
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sekretaria mësimore, është në shërbim të studentëve për të dhënë informacionet e nevojshme apo për ti ndihmuar ata në lidhje me procedurat e regjistrimit apo lëshimin e vërtetimeve të ndryshme të kërkuara nga studentët. Këshilltarët akademikë japin informacione rreth zhvillimit të procesit mësimor dhe nevojave të tjera të studentëve.
Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të	Zyra e informimit dhe e këshillimit të karrierës merret me informimin e studentëve që nga moment i ardhjes së tyre dhe

<p>vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>gjatë të gjithë periudhës së shkollimit; Zyra e shërbimit ndaj studentit informon studentët dhe ndjek shqetësimet e tyre, duke ju dhënë përgjigje studentëve brenda afateve të përcaktuara për zgjidhjen e tyre. Zyra e Marketingut dhe ALUMNI organizon në mënyrë të vazhdueshme aktivitete informuese dhe orientuese në lidhje me punësimin e studentëve të ardhshëm. Kjo zyrë dispononte lista të përditësuara të diplomuarve dhe herë pas here organizon aktivitete me studentët ALUMNI.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Në funksion të shërbimit dhe informimit të studentëve, GVJ konstatoi se këtë vit akademik UMT-ja, me qëllim rritjen e nivelit të performances të studentëve dhe maksimizimin e efektit të punës së tyre ka institucionalizuar sistemin e tutoriatit.</p> <p><i>Evidenca 85 Rregullore e Sekretarisë.pdf</i> <i>Evidenca 77 Rrjeti Alumni dhe aktivitete.</i> <i>Evidenca 73 Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.</i> <i>Evidenca 74 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës.pdf</i> <i>Evidenca 75 Shembull_Java e orientimit_FIA</i> <i>Evidenca 83 Plani i Marketingut UMT</i> <i>Protokolli i takimeve në Institucion</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit V5</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Topografi dhe GIS” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”

a) Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit udhëhiqet dhe realizohet nga kapacitete akademike të specializuara dhe të kualifikuara në fushat e tyre, duke i dhënë prioritet mësimdhënies e mësimnxënies me studentin në qendër, në realizim të objektivave strategjike të institucionit. Ai zbatohet në kushte të përshtatshme infrastrukturore.
2. Programi i studimit me karakter profesional 2 vjeçar (jo universitar) në Topografi GIS është hapur në përgjigje e politikave dhe strategjisë të zhvillimit kombëtar, për t'i ofruar tregut të punës, profesionistë me aftësitë e duhura profesionale.
3. Zhvillimi i procesit mësimor mbështetet me infrastrukture të plotë e të mirëpajisur, ku kontribut të veçantë jep Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike si njësi bazë e UMT-së, gjë që ndihmon në arritjen e standardeve sa më të larta akademike e praktike në realizimin e programit.
4. Kujdesi ndaj studentit realizohet në plotësim të të gjitha kushteve kontraktuale. Në ndihmë të aktivitetit të tyre në mësimnxënje, secili prej tyre, ishte paisur nga departamenti me laptop duke ua lehtësuar kështu si punën në auditor ashtu edhe atë jashtë tij.
5. Ekzistenca e një rrjeti të gjerë partnerësh e bashkëpunëtorësh kombëtarë dhe ndërkombëtare, ekspertë të fushës së shkencave të ndërtimit si pjesë e vazhdueshme e aktiviteteve të FIA, përbejnë “rrugë” mjaft të dobishme për ta çuar “produktin” e këtij programi studimi në të gjitha “destinacionet” ku ai gjen vetveten.
6. Përvoja e krijuar në këtë institucion nga bashkëpunimet, sidomos ato me ndërmarrjet e profilizuara për matje topografike, përpunim gjeotëdhënash me GIS si dhe zbatim projektesh në fushën e ndërtimit, që lidhen me këtë PS, ndikon jo vetëm në konkretizimin e njohurive në auditor por edhe në rritjen e shanseve të punësimit.

b) Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim):

1. Ngarkesa mësimore mbulohet në masën 63% nga stafi akademik efektiv. Është e nevojshme që institucioni të vazhdojë punën në këtë drejtim për të mbuluar 70% të ngarkesës akademike me staf akademik efektiv.
2. Evidentohet një paplotëri literature mësimore për nivelin e edukimit profesional, kjo për shkak edhe të specifikave që ka kjo fushë studimi.

c) Rekomandime:

1. Edhe pse është e vështirë të gjendet staf akademik me tituj dhe grada të specializuara në fushën e Topografisë dhe GIS, institucioni, brenda 2 viteve të ardhshme duhet të mbulojë 70% të ngarkesës akademike me staf akademik efektiv.
2. Institucioni, të vijojë me hartimin dhe zhvillimin e literaturës mësimore nga profesionistë të fushës, të përshtatshme për nivelin e edukimit profesional që ofron ky program studimi, ashtu siç edhe afirmon.

Evaluation Conclusions of the professional study program "Topography and GIS" of the Institution of Higher Education "Metropolitan University of Tirana"

a) Strengths and affirmations :

1. The study program is led and realized by specialized and qualified academic capacities in their fields, giving priority to teaching and learning with the student at the center, in realization of the strategic objectives of the institution. This program is implemented in suitable infrastructural conditions.
2. The 2-year (non-university) professional study program in GIS Topography has been opened in response to national development policies and strategies, to provide the labor market professionals/employees with the appropriate professional skills.
3. The development of the teaching process is supported by a complete and well-equipped infrastructure, where a special contribution is given by the Department of Computer Engineering as a basic unit of UMT, which contribute to achieving the highest academic and practical standards in the implementation of the program.
4. Student care is realized in fulfillment of all contractual conditions. In support of their learning activity, each of them was equipped with a laptop by the department, thus facilitating their work in the auditorium and outside it.
5. The existence of an extensive network of partners, national and international collaborators, experts of the construction sciences field as part of a continuum of FIA activities, constitute "street" quite useful to bring "product" of this study program in all the "destinations" where it finds itself.
6. The experience created in this institution by the collaborations, especially those with profiled enterprises for topographic measurement, processing of geo-data with GIS and implementation of projects in the field of construction, related to this SP, affects not only the concretization of knowledge in the auditorium but also increase employment opportunities.

b) Weaknesses (or points where there is room for improvement)

1. Although the institution covers 63% of the academic load with effective academic staff, it is necessary to work in this direction to cover 70% of the academic load with effective academic staff.
2. There is an incompleteness of teaching literature for the level of professional education, due to the specifics of this field of study.

c) Recommendations:

1. Although it is difficult to find academic staff with titles and degrees specialized in the field of Topography and Giz, the institution, within the next 2 years should cover 70% of the academic load with effective academic staff.
2. The institution, should continue with the compilation and development of teaching literature by professionals in the field, suitable for the level of professional education offered by this study program, as it affirms.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X